

**Etleva LALA**

Vlkshochule Heibronn-Gjermani

Email: etlevalala@yahoo.com

ORCID: 0009-0000-5498-3151

KUD: 94(496.51)“1448”(05)

**BETEJA II-të E KOSOVËS (1448) SIPAS ANTONIO BONFINIT****Abstrakt:**

*Ky studim ofron një perspektivë të re mbi Betejën e Dytë të Kosovës, duke ofruar përkthimin e parë të plotë në shqip të raportit origjinal latin të Antonio Bonfini nga Rerum Hungaricum Decades. Narrativa bashkëkohore e Bonfini, e përfunduar në vitin 1498, është një burim i vlefshëm i asaj kohe për këtë ngjarje kyçe në historinë e Evropës. Përmes një analize të kujdesshme të tekstit të Bonfini, autorja sfidon interpretimet ekzistuese të betejës. Ndërkohë që shumë historianë kanë fajësuar Skanderbegun për disfatën hungareze, Bonfini vendos fajësinë drejtpërdrejt mbi Janosh Huniadi, i cili e filloi parakohe luftën kundër forcave osmane, duke ndryshuar kështu planin e bërë me Skanderbegun. Për më tepër, Bonfini identifikon Gjergj Brankoviqin si tradhtarin kryesor, i cili jo vetëm që minon fushatën e Huniadit duke mos angazhuar forcat e tij ushtarake në këtë luftë, por edhe duke u ofruar inteligjencë sekrete osmanëve. Studimi jo vetëm që paraqet një përkthim të ri, por gjithashtu ofron një analizë kritike të punës së Bonfini, duke dhënë kontekst dhe duke hedhur dritë mbi paragjykimet dhe perspektivat e një kronisti bashkëkohor. Nëpërmjet ekzaminimit të detajuar të Betejës së Dytë të Kosovës, përmes prizmës së narrativës së Bonfini, ky studim kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në të kuptuarit tonë të kësaj ngjarjeje komplekse historike, si dhe të kontekstit më të gjerë të politikës ballkanike të shekullit të pesëmbëdhjetë.*

**Fjalë kyç:** Huniadi, Skënderbeu, Brakoviqi, Sulltan Murati II, Antonio Bonfini, Beteja e Dytë e Kosovës, Lufta antiosmane.

**Abstract:**

*This study offers a new perspective on the Second Battle of Kosovo by presenting the first complete Albanian translation of the original Latin report by Antonio Bonfini from Rerum Hungaricarum Decades. Bonfini's contemporary narrative, completed in 1498, is a valuable source of the period for this key event in European history. Through a careful analysis of Bonfini's text, the author challenges existing interpretations of the battle. While many historians have blamed Skanderbeg for the Hungarian defeat, Bonfini places the responsibility directly on John Hunyadi, who prematurely initiated the confrontation with the Ottoman forces, thereby altering the previously agreed-upon plan with Skanderbeg. Furthermore, Bonfini identifies George Branković as the principal traitor, who not only undermined Hunyadi's campaign by refusing to commit his military forces to the battle, but also provided the Ottomans with secret intelligence. The study not only presents a new translation but also offers a critical analysis of Bonfini's work, providing context and shedding light on the biases and perspectives of a contemporary chronicler. Through a detailed examination of the Second Battle of Kosovo, viewed through the prism of Bonfini's narrative, this study makes a significant contribution to our understanding of this complex historical event and to the broader context of fifteenth-century Balkan politics.*

**Keywords:**

Hunyadi, Skanderbeg, Branković, Sultan Murad II, Antonio Bonfini, Second Battle of Kosovo, Anti-Ottoman Warfare.

Një ndër veprat më të hershme, ku Beteja II e Kosovës përshkruhet pothuajse e plotë, është ajo e humanistit italian Antonio Bonfini me titull: *Rerum Hungaricum Decades* (Dekadat e bëmave të hungarezëve).<sup>1</sup> Këtë vepër Bonfini e shkroi në vitet e fundit të shekullit të pesëmbëdhjetë, rreth 40 vite pas zhvillimit të Betejës. Ai konsulton jo vetëm burimet dokumentare të kohës, por edhe vetë pjesëmarrësit në Betejën II të Kosovës, ose familjarë e miq të tyre që dinin shumë për këtë betejë, duke e bërë këtë pjesë të historisë së tij mjaft të besueshme dhe referenciale.

---

<sup>1</sup> Ajo është botuar e plotë në katër vëllime në serinë e famshme *Bibliotheca Scriptorum Medii Recentisque Aevorum, saeculum XV* me editorë Ed. I. Fogel et B. Iványi et L. Juhász nën titullin: *Antonius de Bonfinis, Rerum ungaricarum decades* në vitin 1936. [https://mek.oszk.hu/20300/20375/pdf/20375\\_3.pdf](https://mek.oszk.hu/20300/20375/pdf/20375_3.pdf) (konsultuar më 10.08.2024).

Humanisti italian Antonio Bonfini u lind në vitin 1427<sup>2</sup> në Ascoli, Piceno të Italisë. Ai u shpërngul në Buda (Budapest) në vitin 1486, me ftesë të mbretit Matias Korvini, në fillim në shërbim të mbretëreshës italiane Beatrice, por që shpejt do të shndërrohej në qendër të *renaissancës* dhe humanizmit në mbretërinë e Hungarisë. Duke fituar një besim të tillë, shpejt atij iu ngarkua projekti i madh i shkrimit të historisë së hungarezëve që nga koha e ardhjes së hunëve në Evropë, një vepër madhore, shkrimi i së cilës zgjati 11 vjet. Mbreti Matias nuk arriti ta shohë atë të përfunduar, duke qenë se vdiq në vitin 1490, por pasardhësi i Matiasit, mbreti Vladislav II, e vlerësoi po kaq shumë punën e Bonfini, duke i dhënë atij titullin e lartë *fisnik*, një pozicion i privilegjuar ky në mbretërinë hungareze. Edhe pse e përfunduar në vitin 1497, botimit të veprës iu desh të priste edhe gati gjysmë shekulli për t'u botuar. *Dritën e botimit ajo e pa në Bazel në vitin 1543, edhe pse në shumë referenca si viti i parë i botimit qëndron viti 1568.*<sup>3</sup> Në këtë studim, ne i referohemi botimit të Bazelit.<sup>4</sup>

Vepra e Bonfini ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në historiografinë hungareze, jo vetëm sepse jep historinë e parë të plotë të Hungarisë, duke krijuar një narrativë që u ndoq për shekuj me radhë në Hungari, por edhe duke e ngritur historiografinë hungareze në një nivel ndërkombëtar të paparë deri në atë kohë, me anë të mënyrës së tij, si informative ashtu edhe interesante për t'u lexuar. Deri në shekullin e tetëmbëdhjetë ajo ishte burimi kryesor me dokumente për historinë hungareze, edhe pse kritikohet për një tendencë të Bonfini *për të mos kamufluar* ndonjëherë të vërtetën. Megjithatë, kjo vepër ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në formimin e identitetit kombëtar hungarez dhe të ndërgjegjësimit historik të hungarezëve. Kopje dhe botime të shumta kanë qenë të përhapura në të gjitha shkollat hungareze. Që në shek-

<sup>2</sup> Disa studiues japin vitin 1437 si vit të lindjes së Antonio Bonfini. Shih zërin biografik te <https://www.britannica.com/biography/Antonio-Bonfini> (konsultuar më 17.08.2024).

<sup>3</sup> Studiuesi Lulëzim Lajçi, në studimin e tij për Luftën e dytë të Kosovës më 1448, i referohet veprës së Bonfini të botuar në vitin 1744. Shih: Lulëzim Lajçi, "Skënderbeu dhe lufta e dytë e Kosovës (17-19 tetor 1448)./Turn to the second battle of. Kosova (17-19 October 1448)". *Studime historike, I*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. (Prishtinë, 2006): 15-52.

<sup>4</sup> Antonius Bonfinius Ascolanensis (Antonio Bonfini), *Rerum Vngaricarum Decades tres, nunc demum industria martini Brenneri Bistriciensis Transsylvani in lucem aeditae, ante hac nunquam excusae. Quibus accesserunt Chronologia Pannonum a Noah usque haec tempora, et Coronis Historiae Vngaricae diuersorum Auctorum. Basileae: Ex Roberti Vvinter Officina, anno MDXLIII (1543). Cum Caesarea Maiestatis gratia et privilegio ad annos sex.* [https://books.google.it/books?id=\\_gRPAAAAcAAJ&printsec=frontcover#v=onepage&q&f=false](https://books.google.it/books?id=_gRPAAAAcAAJ&printsec=frontcover#v=onepage&q&f=false) (konsultuar më 17.08.2024) [Në vijim: Bonfini, *Decades III*].

ullin e gjashtëmbëdhjetë, ka burime që dëshmojnë se ka pasur disa kopje të vetë dorëshkrimit të Bonfini, disa prej të cilave ruhen akoma në arkivat dhe bibliotekat e Hungarisë. Përkthimi i parë në hungarisht është bërë nga *Gáspár Heltai* me titull *Chronika az magyarok viselt dolgairól*, dhe u botua në vitin 1575 në Kluj (në atë kohë Kolozsvár të Transilvanisë).

Në veprën e tij, Bonfini i kushton disa faqe luftës së tetorit të vitit 1448 në Fushë të Kosovës. Përveç informacioneve të cilat mund të jenë tashmë të njohura për lexuesin edhe nga burime e studime të tjera të mëvonshme, vlera e këtij burimi qëndron në autenticitetin e tij dhe sidomos në mënyrën se si humbja u prit dhe u përpunua nga hungarezët. *Nihil hinc Ungarice genti turpitudinis accidisse* (asnjë turp nuk i vjen popullit hungarez nga kjo) shkruan Antonio Bonfini, duke pasqyruar qartazi frymën me të cilën ishte pranuar fati i kësaj beteje.

Kjo shprehje flet qartë për humbjen e thellë të nderit dhe të krenarisë që ka shkaktuar kjo humbje, gjë që humanisti Bonfini përpiqet ta kompensojë duke e cekur në veprën e tij, duke u përpjekur ta shfaqë atë në një prizëm tjetër. Duke u përpjekur të jetë sa më realist në përshkrimet e tij, ai vë gishtin mbi plagë duke treguar se kujt duhet t'i vinte turp nga rezultatet e kësaj beteje dhe se çfarë roli të madh luante turpi dhe nderi në betejat e mesjetës. Vlerat morale që i bashkëngjiteshin fitores apo humbjes ishin të tilla që mbeteshin të pashlyeshme në memorien kolektive, jo vetëm të atyre që kishin marrë pjesë në të, po edhe të të gjithë popullit. Përpara se të japim e tekstin e Bonfini në shqip dhe komentet përkatëse për çdo pjesë të tij, po sqarojmë shkurt kontekstin historik, sidomos për sa i përket terminologjisë<sup>5</sup> që ka përdorur autori.

Duke qenë i angazhuar nga mbreti Matias Korvini për të shkruar historinë e hungarezëve, sigurisht që terminologjia e zgjedhur nga ai pasqyron edhe dëshirat dhe aspiratat e këtij mbreti jashtëzakonisht të famshëm e të dashur nga hungarezët, për të krijuar dinastinë e tij dhe për ta përjetësuar atë edhe në gjuhë. Në këtë kontekst del edhe emri i Janosh Huniadi, babait të Matias Korvinit, si Janos Korvini. Matias Korvini u bë i famshëm në popull sidomos për shkak të humanizmit që përqafoi në sundimin e tij mbretëror. Nuk e dimë, në fakt, me saktësi nëse ishte dëshira e Matias Korvinit që babai i tij, Janosh Huniadi të quhej me mbiemrin e famshëm të mbretit Korvin, apo ishte ideja

<sup>5</sup> Bazilije Pandžić, "I francescani a servizio dell'Albania nell'epoca di Scanderbeg", në: *V Convegno internazionale di studi Albanesi. /V Mbledhje ndërkombëtare studimesh Shqiptare. IX 1968. Atti-Aktet/*. (Palermo: Scuola Grafica Salesiana-Palermo, 1969): 177-202, këtu: 179.

dhe vendimi i vetë Bonfini për një gjë të tillë. Gjithsesi, gjatë gjithë tekstit të Bonfini, Janosh Huniadi quhet Janosh Korvini.<sup>6</sup> Në përkthim kemi ruajtur origjinalin, d.m.th. mbiemrin Korvini, edhe pse flitet për Huniadin, kurse në komente kemi përdorur emrin e Huniadit, ashtu siç e njohim në historiografinë bashkëkohore.

Përshkrimi i Betejës II të Kosovës fillon në faqen 471, ku flitet për përgatitjet e Huniadit për betejën e vitit 1448.

*Prandaj, Korvini, i cili në kohën e tij të lirë merrej me përgatitjen për ekspeditën kundër turqve, në vitin e katërt të sundimit të tij, që ishte vitit 1448, u nis nga kështjellat e Hungarisë me njëzetë e dy mijë burra.<sup>7</sup>*

Duhet të kemi parasysh që teksti është shkruar në shekullin e pesëm-bëdhjetë, dhe kur autori përdori termin *turk*, nuk ka parasysh as turqit dhe as Turqinë e sotme. Në historiografinë bashkëkohore dhe në komentet tona ne

---

<sup>6</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 424: Quin etiam Ioannem Unniadem, quo prestantiorem domi milieque virum illa tempora non viderunt, ut deinceps, cum res ipsa postularit, sat copiose referemus, Polono nimium favisse addictum perhibetur. Hic enim Valacho patre, matre vero Greca natus industria et virtute supra omnium opinionem suum genus illustravit; parentibus nequaquam obscuris editum tradidere. Pater nanque inter Valachos, qui Getarum Dacorumque loca nunc incolunt et e Romanis superfuisse colonis, veluti lingue similitudo testatur, sane creduntur, plurimum apud eam gentem potuisse dicilur. Quippe qui non consilio solum ac longa rerum experientia, sed opibus et fortunis multum sibi auctoritatis compararat, assiduo bello exercitatus non p'us divitiarum quam nominis e militaribus studiis ipse contraxerat. In Corvino vico natus in Corvinam Romanorum familiam genus retulit. Mater vero e Grecis edita e veteri et imperatorio sanguine promanasse credita est. Nonnulli in Theodosii hanc genus referre audent. Servivit a principio cum XII equis Demetrio episcopo Zagabriensi et in Italia duos annos sub duce Philippo Mediolanensi prima stipendia meruit, nam Sigismundum in Italiam secutus remansit. Sigismundum enim affirmant fama paterni nominis Ioannem adhuc ephelum e Transalpinis oris in Transylvaniam transtulisse, Unniaticis prediis, que in extrema Transylvanie ora, que ad Valachiam attinet, sita sunt, ob rem bene gestam donasse. Prima hunc stipendia sub Ungaro ale prefecto fecisse memorant. Nosque a divo Mathia nonnunquam audivimus, cum prefecti cuiusdam filium in conspectum admitieret, quod de patre conversus ad alios ingepue fatebatur. Hic est, inquit, illius optimatis gnatus, sub quo pater meus primum meruit vocemque centurionis expavit, mox propria virtute fortuneque dextertate fretus munia queque militie honorificentissime gessit, ex bono tirone miles fortissimus, ex milite imperator optimus emersit. Per singulos ordines miro laudis glorieque successu iam evectus provincias cum imperio sortiri cepit, cum prestantissima Gereborum domo affinitatem inivit. Hinc Elisabetham, que Ladislaum Mathiamque genuit, uxorem duxit.

<sup>7</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 471: Corvinus igitur, qui ocii tempore nil magis sollicite agitarat, quam Turcicae expeditionis apparatus, quarto suae gubernationis anno, Salutis uero Christianae, quadragesimo octavo supra millesimum et quadringentesimum, cum duobus et viginti milibus hominum, ex Ungaria castra mouit.

përdorim termin *otoman*,<sup>8</sup> por në tekstin origjinal dhe në përkthim është ruajtur termi *turk*, siç e ka përdorur autori në atë kohë.<sup>9</sup>

Në fillim të përshkrimit të betejës, Bonfini përmend formacionin ushtarak të ushtrisë së Huniadit,<sup>10</sup> duke mos harruar të përmendë një nga një të gjithë personalitetet që e shoqërojnë atë në këtë betejë.

*Në fakt, ai kishte edhe vojvodën e zonës malore të Vllahisë si aleat në këtë luftë. I shoqëruar nga legati apostolik, ipeshkvi i Koronës, Korvini, gjithmonë i kujdesshëm në sipërmarrjet e mëdha, shoqërohej nga fisnikëria më e lartë e Hungarisë: Emeriku, Voivoda i Transilvanisë, Peli; vëllai i tij, Ladislaus; Emerik Marzalius, mjeshtër i oborrit mbretëror; Raynald Rosgoinus; Thomas Zeech; e për më tepër edhe nga Francis Tholomicius, prefekt i Dalmacisë Kroacisë; Jan Zechel, kunati i Korvinit; Benedikt Losoncius; Stefan Banfi; Nikolas Banfi, babai i banit të mëparshëm dhe djali i banit të mëparshëm, që quheshin 'de Lindua'. Përveç këtyre ishte edhe Georgius Ciacus, Robert Carrus, Jan Corothna, kuestor, të cilin tani e quanin edhe gjykatës të mbretërisë, si dhe një sasi e panumërt fisnikësh.*<sup>11</sup>

Në vazhdim, Bonfini përshkruan në detaje rrugën nëpër të cilën kalon ushtria e Huniadit si dhe përqendrohet te sundimtarët që priste t'i bashkoheshin rrugës në këtë mision të shenjtë.<sup>12</sup> Në këtë përshkrim rruge, Bonfini

<sup>8</sup> Gjon Berisha, "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe qëndrimi *modus vivendi* i Republikës së Raguzës", në: *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550 – vjeotrin e vdekjes*. (Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes", mbajtur në Prishtinë, më 16 tetor 2018). (Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, 2019): 15-41, këtu: 20 dhe ref. 14.

<sup>9</sup> Aurel Plasari, *Skënderbeu. Një histori politike*. Instituti i Studimeve Shqiptare "Gjergj Fishta" Tiranë. (Tiranë: Instituti i Studimeve Shqiptare "Gjergj Fishta," 2010).

<sup>10</sup> Shih: Mita Kostić, "Opis vojske Jovana Hunijadia pri polaska u boj na Kosovo", në: *Gladnik Skopskog naučnog društva*. (*Bulletin de la société scientifique de Skoplje*). Knjiga (Tome) I, sveska (fasc) 1-2. (Skoplje, 1926): 79(1) – 91(13), këtu: 89(11).

<sup>11</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 471: Valachiae nanque montanae Vaiodam (ut aiunt) in huiusce belli societatem asciverat. Corvinum magna semper coepta auspiciantem, Legatus in primis apostolicus sequebatur, Coronensis Episcopus; e Proceribus autem Ungariae, Emericus Pelusiensis Vaiuoda Transylvanus, Ladislaus frater eius, Emericus Marzalius ianitorum Regalium magister, Raynaldus Rosgoinus, Thomas Zeech, insuper Francus Tholomicius Dalmatiae Croaciaeque praefectus, Ioannes Zechel Corvini frater, Benedictus Losoncius, Stephanus Banffi, Nicolai Banffi pater, et Bani quondam filius quibus quidem omnibus de Lindua cognomen erat. Praeterea Georgius Ciacus, Robertus Carrus, Ioannes Corothna quadruumuir, quem nunc Regni Iudicem appellant: et innumera nobilium multitudo sequuta.

<sup>12</sup> Jovan Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*. Istoriska građa. Spomenik XCV. Drugi razred, knj. 74. Srpska Kraljevska Akademija. (Beograd: SKA, 1942), vell. XCV, bleni 74: 16-17, dok. 23 dhe 17-18, dok. 24.

është mjaft i besueshëm, sepse informacionin e ka marrë nga ata që i kanë shkelur vetë të gjitha këto shtigje.

*Ata e filluan rrugën përmes Danubit, kaluan lumin Tiba dhe zbritën përmes Dacisë në Misi. Kur arritën në Kubin, nga ku shihnin edhe Misinë, pak më poshtë se lumi Morava, i cili rrjedh nëpër Misi dhe derdhet në Danub, kaluan lumin Ister dhe qytetin Severin.<sup>13</sup>*

Negociatat me pushtetin lokal me siguri janë bërë publike për shumicën e luftëtarëve, duke qenë se Huniadi dëshironte transparencë në këtë mision të shenjtë, të paktën me njerëzit besnikë që e shoqëronin kudo, e sidomos në një mision të tillë. Ngjyrat emocionale mund të jenë të ekzagjuruara, por që thelbi i këtyre negociatave mbetet i pandryshueshëm. Një rast i tillë është ai i përshkruar më poshtë, e që ka të bëjë me despotin e Serbisë, Gjergj Brankoviçin.

*Kur ishin në bregun tjetër të Danubit, Korvini i dërgoi legatët e tij Despotit, i cili po përpiquej të ruante paqen me turqit nëpërmjet lajmëtarëve sekretë, pasi kishte rimarrë mbretërinë e Misisë. Korvini i kërkoi atij, ashtu siç kishte bërë edhe më parë, që t'i bashkohej edhe ai në këtë ekspeditë të shenjtë dhe të ishte i vetëdijshëm për privilegjet që do të kishte nga hungarezët, si dhe për pasojat nëse do të tregohej mosmirënjohës, sepse asgjë nuk e çnderon dinjitetin e një njeriu të mirë më shumë sesa një rast i tillë.<sup>14</sup>*

Huniadi kërkon me çdo kusht që ta ketë Despotin Brankoviçin në këtë ekspeditë dhe për këtë jep shumë arsye, ku ndër të tjera përshkruan edhe ushtrinë e tij, duke vënë theksin te koalicioni i ushtrive të krishtera, për t'i bërë sa më bindëse argumentet e tij.

*Për më tepër, ai (Huniadi) e nxit që të ketë shpresa të mëdha për këtë luftë, duke qenë se nuk mungojnë as paratë dhe as trupat. Ai shton që udhëheq një ushtri prej njëzetë e dy mijë trupave, bashkë me ndihmat vllehe. Asgjë pra nuk mungonte për këtë ekspeditë ushtarake, me përjashtim të Despotit, princit të Rashës, këshilla dhe forcat e të cilit ishin shumë të dëshiruara*

<sup>13</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 471: Iter Transdanubium inivere, superato Tibisco amne, per Daciam in Mysiam descenderunt, sed ubi ad Cubin, in conspectum Mysiae pervenerunt, paulo infra ubi Moravia fluvius, per Mysiam currens, in Danubium fertur, Istrum traiecerunt, ad Severinum oppidum alii transmisere.

<sup>14</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 471: At postquam in adversa Danubii ripa constitere, Corvinus Despotem, qui clandestinis cum Turca internunciis, recuperato Mysiae Regno, pacem seruare nitebatur, per Legatos horratur, et orat, ut saepe a se rogatus, ad sacram expeditionem veniat, beneficiorumque quae ab Ungaris acceperit, memor esse velit, et ingratitude infamiam caveat; qua nihil boni viri dignitatem magis dehonestat.

*që të ndihmonin këtë ekspeditë. Për këtë arsye, ai iu lut atij seriozisht që të mblidhte urgjentisht trupat kalorsiake dhe ta ndiqte në kampin e tij.<sup>15</sup>*

Despoti i Rashës, Gjergj Brankoviqi, nuk dëshiron të luftojë kundër osmanëve dhe për këtë jep shumë arsye. Fakti që ai rreshton gjithë ato arsye tregon qartë se të gjitha janë të sajua, dhe jo për pamundësinë e tij për të marrë pjesë në betejë. Ai shtiret i sëmurë, i frikësuar nga përvoja e Varnës, gjë që nuk harron t'ia përmendë Huniadit, për t'ia kujtuar disfatën e hungarezëve në këtë betejë.<sup>16</sup>

*Por duke qenë i sëmurë, ai kërkoi falje në shumë mënyra për ta refuzuar me nder këtë shërbim ushtarak. Së pari, ai iu referua paqes që kishte bërë me turqit, edhe pse kundër dëshirës së tij, dhe, edhe pse e kishte prishur disi në betejën e Varnës, vazhdonte ta ruante në saje të faljes që i kishte bërë Murati. Në të kundërtën do të binte përsëri në gjendjen e mjerueshme në të cilën kishte qenë më parë. Ai ia vuri fajin edhe kohës së keqe, duke qenë se kishin ardhur në Severin në fillim të vjeshtës, dhe i tregoi sa vështirë është luftosh në zonat e ftohta në një kohë kur të tjerët po dimërojnë tashmë, gjë për të cilën thotë se e kishte mësuar nga lufta e mëparshme, dhe jo pa pasoja. Despoti i shpiku këto e gjëra të tjera për të refuzuar me nder, por zilia e kishte pllakosur këtë njeri thellë, pse Korvini ishte bërë guvernator dhe jo ai. Si despot dhe mbret i Misisë, i lindur nga gjak perandorak, ai e konsideronte për turp të vihej në shërbim të një guvernatori dhe e konsideronte veten më të denjë e më të lartë sesa e kishin trajtuar. Ai ishte smirëzi dhe për këtë arsye nuk donte të merrte pjesë në këtë kauzë.<sup>17</sup>*

<sup>15</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 471: Insuper affirmabat, de bello bene sperandum, quando neque pecuniae, neque copiae deforent. Duorum et viginti milium se ductare exercitum, accessisse Valachorum auxilia; nihil huic militiae, praeter Despotem, Rasciae Principem, deesse; cuius consilio ac viribus, si praesens expeditio adiuvetur, nihil ultra exoptari posse. Proinde impensius orare, ut coactis continuo equitum turmis expeditissimorum, sua castra sequeretur.

<sup>16</sup> Shih Petar Matković, "Putovanja po balkanskom poluotoku XVI. veka. Napisao Dr. Petar Matković. I. Fedlix Petančić i njegov opis puteva u Tursku. Preštampano iz XLIX knjige Rada jugoslovenske akademije znanosti i umjetnosti. (Zagreb: Tisak Dioničke Tiskare, 1879): 1-92.

<sup>17</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 471: At ille male sentiens, ut honestius militiam detrectaret, variis se modis excusat. In primis pacem causatur, quam cum Turca initam, quamvis invitus, aliquantis per Varnensi bello violasset, adhuc tamen Amurathis indulgentia seruatam, continuare studeret, ne in pristinam miseriam recideret. Item importunitatem temporis arguit, quod praecipiti autumno Seuerinum applicuerant; et quam difficile sit, dum hibernant alii, in frigidis regionibus bellum agere; quod sat a superiore bello haud impune didicere. Haec et multa alia, ut se iturum honestius abnegaret, Despotes comminiscitur. Sed uirum liuor ma-

Bonfini përpiqet të gjejë arsyet e refuzimit të Brankoviçit dhe ngaqë nuk arrin të kuptojë se si e përse një i krishterë nuk merr pjesë në një betejë kaq të shenjtë e të rëndësishme për krishterimin, përpiqet ta shpjegojë këtë fenomen me meskinitetin e natyrës njerëzore, ku smira dhe zilia e njerëzve të vegjël mbizotëron dhe shkatërron edhe detyra misioni kaq të shenjta e të rëndësishme.

*I inatosur nga këto përgjigje, Korvini e kërcënoi shumë seriozisht që do ta shpaguante me duart e tij këtë njeri kaq mosmirënjohës, madje sipas metodës indiane, me vdekje, dhe nëse do të dilte fitimtar nga kjo luftë, do ta vendoste Mbretërinë e Rashës në duart e një personi të denjë. Ai u nis me shpejtësi drejt Bullgarisë duke ikur përmes Misisë, si përmes një zone armiqësore. Kur Korvini u largua, despoti iu kthye menjëherë tradhtisë dhe nëpërmjet korrierëve të shpejtë e informoi Muratin për ardhjen e hungarezëve dhe sasinë e trupave të tyre. Në fakt, ai raportoi edhe për lëvizjet e tyre ditore, si për shkak të zilisë, ashtu edhe për shkak të servilizmit, sepse ai ishte i bindur që mund ta ruante lehtë paqen me të. Për më tepër, ai e informoi armikun që Korvini kishte ardhur vetëm me një ushtri të vogël dhe që ai nuk kishte pse t'i trembej. Përveç kësaj, e siguroi që armikut nuk i duhej prerë rruga në asnjë mënyrë, por duhej lejuar të avanconte më në thellësi, dhe që pastaj t'i pritej rruga e kthimit, dhe nëse ai e bënte këtë, e siguroi që Korvini nuk do të kthehej kurrë më prej atje.<sup>18</sup>*

Bonfini e përshkruan Brankoviçin si një tradhtar të mirëfilltë të çështjes së krishterë. Në këtë kuadër e vendos edhe zemërimin e Huniadit kundër tij. Është interesant interpretimi që i bëhet në ditët tona kalimit të Huniadit nëpër

---

gis incesserat, aegerrime nanque ferebat, data sibi repulsa, Corvinum Gubernatorem fuisse creatum. Subpudere quoque se Despotem ac Mysiae Regem, imperatoris genere natum, sub gubernatoris ductu et auspiciis militare; multoque maiore se honore dignum esse censebat, quam gerere potuisset; invidia sese recognoscere, et aliquid in hac re pensi habere, minime patiebatur.

<sup>18</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 471: Corvinus ad haec responsa succensus, admodum interminat, se suis omnino manibus ingratisimum hominem indorum exemplo, capite mulctaturum; Rasciae Regnum digniori traditurum, si ex hoc bello victor euaserit. Mox per Mysiam, haud aliter atque per infestam regionem, iter in Bulgariam intendit. Despotes, abeunte Corvino, ad perfidiam illico conversus, celeribus internunciis, Ungarorum adventus, et copiarum multitudinis Amurathem admonuit; quin et quotidiana significat itinera, quum inuidiae, tum gratificationis gratia, qua pacem cum eo facile servatum iri confidebat. Item edocuit, Corvinum cum modicis illac copiis traiecisse, nil ipsi timere oportere, Praterea hosti haud quaquam occurrendum, sed (f. 472) Permittendum ultra progredi, mox a tergo iter obstruendum; quod si fecerit, illum nunquam inde rediturum asseverabat.

këto territore: “Në shtator dhe tetor 1448, Huniadi marshoi përmes Serbisë, duke djegur dhe plaçkitur sikur Brankoviçi dhe serbët të ishin armiqtë e tij dhe jo turqit,<sup>19</sup> shkruan Setton, duke bërë të duket sikur veprimet e Brankoviqit ishin pasojë e veprimeve të Huniadit dhe jo anasjelltas. Bonfini na tregon se çfarë ka ndodhur në të vërtetë dhe cilat ishin arsyet e Huniadit dhe të ushtrisë së tij për një sjellje barbare që vazhdon edhe më vonë.

Përmendja e metodës indiane është gjithashtu interesante në këtë kontekst, sepse dihet që kontaktet me indianët janë akoma në fillimet e tyre. Ky informacion flet për njohuritë e Bonfini që ishin në nivelet më të larta të dijes bashkëkohore, po të kemi parasysh që Amerika u zbulua në vitin 1492 nga Kristofor Kolombi, pra vetëm pesë vite para se Bonfini të mbaronte veprën e tij dhe informacioni nuk përhapej me shpejtësinë që e lejon media në ditët e sotme. Në kontekstin e dhënë, termi “metodë indiane” nënkupton një kulturë barbare, të pacivilizuar dhe brutale, dhe nuk ka ndonjë relevancë historike për ndonjë metodë vërtet indiane.

Bonfini përmend edhe të tjerë personalitete lokale kur përshkruan Luftën II të Kosovës dhe konkretisht Skënderbeun, duke iu referuar atij me shumë pozitivitet dhe respekt.<sup>20</sup> Në tekstin e Bonfini, emri i Skënderbeut del në variantin *Sandorobeg* ose *Sandarobeg*, gjë që tregon se emri i Skënderbeut lidhet më shumë me formën hungareze, Sandor (lexohet Shandor), të Aleksandrit të Madh dhe me famën e tij, sesa me formën e islamizuar, Skander, që është futur në historiografi. Vlen të studiohet nëse emri Sandor (Shandor) fitoi popullaritet në Hungari për shkak të Skënderbeut, apo ekzistonte tashmë edhe në mesjetë si pasqyrim i lavdisë së Aleksandrit të Madh edhe ndër hungarezët.

*Megjithatë, Korvini i angazhuar në një luftë shumë serioze, po nxitonte me gjithë fuqinë e ushtrisë së tij, duke e nxitur Sandorobegun, princin e shqiptarëve me letra të shpeshta, me të cilin kishte bërë një marrëveshje kundër turqve, të nxitonte meqenëse vetë po i afrohej armikut. Me të ai kishte planifikuar që vetë, bashkë me hungarezët, do të avanconte nga Rasha për në Bullgari, ndërsa tjetri do t'i sulmonte turqit në të njëjtën kohë nga Iliria, me*

<sup>19</sup> “In September and October 1448, the impatient Hunyadi marched through Serbia, burning and pillaging as though Branković and the Serbs were his enemies instead of the Turks.” Kenneth, Setton (1997) [1978]. *The papacy and the Levant, 1204-1571: The thirteenth and fourteenth centuries*. Vëll. II. (Philadelphia: American Philosophical Society, (1997) 1978), f. 99.

<sup>20</sup> Aurel Plasari, *Arbni historik, gjeografik, kishtar dhe politik*. Akademia e Shkencave Albanologjike. *Botimi i dytë*. (Tiranë: Onufri, 2020).

*qëllim që, duke sulmuar përballë dhe nga ana, ta mundnin më lehtë atë. Kjo nuk ndodhi, sepse Sandarobegu, të cilin barbarët e quanin z. Aleksandër, nuk arriti në betejë në kohën kur filloi ajo. Nxitimi i parakohshëm i fillimit të betejës e ndërpreu zbatimin e planit.<sup>21</sup>*

Bonfini nuk e fajëson Skënderbeun për dështimin e planit të thurur mes Huniadit dhe Skënderbeut, por Huniadin, duke vënë theksin te parakohshmëria e fillimit të betejës nga ana e Huniadit, gjë që ia bëri të pamundur Skënderbeut të ishte atje në kohën kur ajo filloi. Ndërkohë, pothuajse gjatë gjithë rrëfimit të Bonfini temë bosht është tradhtia e Despotit të Serbisë, Gjergj Brankoviq.

*Murati, duke dëgjuar këshillën e despotit të tij, nuk i doli para Korvinit që po pushtonte mbretërinë, duke e lejuar armikun të avanconte thellë. Vetë e ndiqte atë duke ruajtur një distancë prej dy ose tre ditësh, duke i bllokuar rrugën nga pas, që të mos mund të tërhiqej.<sup>22</sup>*

Vendi ku u zhvillua beteja është një ndër aspektet më të rëndësishme në përshkrimin e Bonfini. Bonfini jep të dhëna që beteja nuk u zhvillua në territorin e Brankoviqit, por në kufijtë midis Rashës dhe Bullgarisë. Ai jep edhe terminologjinë përkatëse me të cilën njihej ky territor në mesjetë:

*Të dyja palët arritën të një fushë që shtrihet në kufirin midis Rashës dhe Bullgarisë, dhe që hungarezët tani e quajnë Rigomezö, rashianët e quajnë Kosonë dhe ne po e përkthejmë si fusha e Merulës. Një lumë e përshkon këtë fushë. Ai quhet Skithnicë dhe buron nga malet e Ilirisë, dhe pasi ka rrjedhur për ca kohë, derdhet në Ister. Fusha është 20 milje e gjatë dhe 5 e gjerë. Ajo kufizohet nga të dyja anët nga male shumë të këndshme në formë rrethore, dhe lumi rrethuar nga malet dhe me lugina të fshehta, si dhe nga shumë fshatra të bukur.<sup>23</sup>*

<sup>21</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Corvinus autem gravissimo bello intentus iter pro uirili sua properare, creberrimis Sandorobechum Albanensium principem literis vexare, quo quum adversus Turcam paulo ante foedus percusserat, ut appropriaret, quando iam ipse hostibus appropinquabat; Ita enim cum eo consilium iniverat, ut ipse cum Ungaris a Rascia Bulgariaeque, ille ab Illyrico Turcis pariter occurrerent, ut a fronte tergoque vexati facile vincerentur. Quod haud ab re fuisset, si Sandarobechus, quem illi barbare Alexandrum dominum vocant, praelio in tempore adfuisset. Sed immatura pugne festinatio recti consilii finem intercepit.

<sup>22</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Amurathes despotis consilia nequaquam aspernatus Corvino regnum invadenti non occurrit, permisit hostem ultra progedi atque ipse duorum trium ve dierum itinere subsequitur a tergoque, ne retro pedem referre possit, iter obstruit.

<sup>23</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Iam in planiciem uterque pervenerat, quem in Rasciae Bulgariaeque finibus longe lateque spatiantem Rigomezeneu Ungari, Rasciani Cosonam nunc vocant, nos Campum Merule interpretamur. Hanc fluvius interfluit, qui Schithniza nunc dicitur

Zgjedhja e këtij vendi për t'u ndeshur me ushtritë osmane duket se ishte e qëllimshme dhe jo e rastësishme nga ana e Huniadit. Bonfini e përshkuan atë si një arenë ku banorët e fshatrave përreth e dinin tashmë se çfarë do të ndodhte dhe përpiqeshin madje të parashikonin se kush do të fitonte, në bazë të shenjave që linin ushtritë apo ndoshta edhe në bazë të bestytnive e shenjave paralajmëruese që besonin.

*Kur hungarezët dhe pastaj turqit zbritën në fushë sikur po zbrisnin në një arenë, një plakë nga një fshat që është në hyrje të fushës, thirri: 'Sa keq! Kam frikë se hungarezët nuk do kenë fat në këtë luftë, sepse kur kaloi lumin ushtria e tyre, nuk e turbulluan as për një ditë ujin, ndërkohë që kur kaluan turqit, tre ditë ishte lumi i turbullt, 'sikur po parashikonte një katastrofë të adhshme për shkak të mungesës së mjeteve.<sup>24</sup>*

Në këta rreshta shohim rolin që luante supersticioni në betejat e mesjetës. Shprehja *In malum hostis austicium* hedh dritë mbi besimin në fatin e keq dhe shenjat paralajmëruese të fatit të keq në betejat mesjetare. Fakti që edhe Sulltan Murati II, i cili udhëheq ushtrinë osmane në këtë betejë, ka të njëjtën frikë, që e lidh me vende dhe me fatin e keq të paraardhësve të tij, lë të kuptohet që supersticioni ishte kaq i pranishëm dhe i rëndësishëm për udhëheqësit e mesjetës, sa që në bazë të shenjave drejtoreshin edhe strategjitë ushtarake apo veprimet e tjera të tyre.

Për qëllimshmërinë e zgjedhjes së vendit të betejës flet edhe përshkrimi i mëposhtëm, ku kulla ku ishte varrosur Sulltan Murati I del si një vend me rëndësi strategjike, dhe pushtimi i saj do të ishte një avantazh dhe fitore simbolike. E megjithatë, Sulltan Murati II nuk dëshiron t'i afrohet asaj dhe aq më pak ta pushtojë, sepse ka frikë se mund të pësojë të njëjtin fat si Sulltan Murati I, i cili ishte varrosur aty. Në vend që të shkojë menjëherë atje, ai kërkon ta provokojë armikun Huniad, të luftojnë pa arritur te kulla, me qëllim që, duke shmangur këtë vend ogurzi, të shmangë edhe fatin e Sulltan Muratit I, i cili ishte vrarë në Betejën e Parë të Kosovës, në vitin 1389. Frika e Muratit

---

et ab Illyrici montibus defluens aliquandiu vagatus Istrum inuenit. Campi huiusce longitudo passuum est viginti milium, quinque milia continet latitudo. Circumvallatur utrinque montibus amoenissimis in circi speciem et fluvius ac montium appendices reconditaeque convalles proxime haud iniucunda vicorum frequentia celebratur.

<sup>24</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Quum in campum haud aliter atque in agona prius Ungari, deinde Turci descenderent, ad pagum amnis accolam, qui in aditu situs est, anus exclamavit: Heu quam vereor, ne parum aquis Ungari nunc dimicant auspiciis, quando traiectus eorum vado exercitus vix unum, Turcarum vere dies tres fluvium perturbavit veluti futuram cladem ex inopia copiarum hariolaretur.

flet qartë për luftën psikologjike mesjetare, që ishte një komponent shumë i rëndësishëm i strategjisë ushtarake. Duke pasur frikë nga shenjat e këqija, udhëheqësit e ushtrive shpesh ndryshonin edhe strategjitë e luftës.

*Në pothuajse mes të fushës ngrihet një kodër e vogël, në fund të së cilës rrjedh lumi Skithnica. Jo larg prej aty, aty ku fillojnë ujërat, ndodhet një kullë, që dikur shërbente si varr dhe piramidë e njëfarë Murati, i cili, pasi humbi ushtrinë, u vra dhe u varros aty. Murati tani kishte frikë që Korvini, duke ardhur më herët, do ta pushtonte piramidën, gjë që do të ishte shenjë e keqe për armikun.<sup>25</sup>*

Sulltan Murati II duket i shqetësuar që armiku i tij, Huniadi, do ta përdorte këtë vend – ku kishte rënë dhe ishte varrosur paraardhësi i tij, Sulltan Murati I – si strategji gjeografike dhe psikologjike në favor të tij. Prandaj, ai përpiqet t'i japë një drejtim tjetër betejës së paraparë, duke ndryshuar kohën e zhvillimit të saj. Për këtë arsye, siç do të shohim më poshtë, ai fillon ta provokojë Huniadin që të fillojë luftën pa qenë akoma gati për të luftuar.

*Për këtë arsye, ai i ndoqi ata më nga afër, me qëllim që ta fillonte betejën para se të arrinte kullën. Korvini kishte arritur në kodrën që ishte në mes të fushës dhe kishte ngritur kampin e tij atje, duke pritur për përforcimet e Sandarobegut, i cili pritej të vinte brenda orës. Duke pasur frikë që do të push-tohej kulla dhe do të vinin përforcimet ilire, Murati e provokoi Korvinin për betejë. Ky i fundit refuzonte duke pritur derisa të vinin përforcimet nga Iliria. Murati ushtronte presion më me këmbëngulje, duke ndërprerë ujin dhe drutë e zjarrit, duke ndërprerë ushqimet, si dhe duke e ngacmuar në çdo mënyrë që mundej, me të gjithë aftësitë dhe forcën. Guximi i turqve ishte rritur nga sasia e madhe e trupave të tyre, të cilat thuhej se arrinin në tetëdhjetë mijë burra.<sup>26</sup>*

<sup>25</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: In media fere planitie collis modicus assurgit, cuius radices Schithniza lambit. Non multo ulterius ad caput aequoris quaedam turrus erat cuiusdam olim Amorathis tumulus et pyramis, qui profligato exercitu ibi caesus et sepultus est. Illud quoque nunc Amuraths verebatur, ne Corvinus, qui praecesserat, in malum hostis auspicium pyramidem praeoccuparet.

<sup>26</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Quare pleniore gradu subsequitur, ut prius cum eo manum conserat, quam in turrum attingat. Ad collem igitur Corvinus venerat in medio campo surgen-tem et in eo castra locat Sandarobechi auxilia expectaturus, qui in horas accurrere dicebatur. Amurathes veritus, ne proxima turrus occupetur et Illyricorum auxilia superveniant, Corvinum irritat ad praelium; Detrectat ille, donec ab Illyrico auxilia veniant. Hic multo impensius instat, aquationem lignationemque inhibet, pabula praeripit et, qua potest, arte vique lacessit; addebat Turca audaciam ingens copiarum multitudo, quas octoginta circiter milia hominum esse ferebatur.

Sulltan Murati II i bën presion Huniadit nëpërmjet domosdoshmërive për të mbijetuar, konkretisht nëpërmjet ujit, ushqimit dhe druve. Uji dhe ushqimet, dhe në këtë rast edhe drutë për t'u ngrohur apo për të gatuar, bëhen pikërisht mjetet më efikase të luftës së Sulltan Muratit II kundër ushtrisë së Huniadit. Nuk kemi të dhëna që Huniadi të jetë rrethuar nga ushtria osmane në këtë betejë, megjithatë ushtria e Huniadit nuk arrin të furnizohet me këto elemente bazë të mbijetesës. Kjo tregon se edhe pse jo i rrethuar nga osmanët, Huniadi ishte i rrethuar nga armiq, gjë që, indirekt, flet për një pozicion armiqësor të zonës ku ndodhej, kjo e detyroi atë të hidhej në fushëbetejë pa qenë i përgatitur.<sup>27</sup>

*Pa dëshirë, Korvini u detyrua të zbresë në fushëbetejë kur i mbaruan uji dhe ushqimet. Kështu, ditën e festës së Shën Lukës, ditë e enjte, e urdhëroi ushtrinë të armatosej. Ai e ndau atë në tridhjetë e dy skuadronë dhe përgatiti e përforcoi të gjitha fortifikimet në kodër kundër armikut. Më pas i urdhëroi ushtarët të kryenin ritet e shenjta ndaj Zotit të Shenjtë, të bënë rrëfimin mistik me njëri-tjetrin, si dhe meshën tokësore. Pastaj i shoqëroi ushtarët për në betejë.*<sup>28</sup>

Studiuesit bien dakord që Lufta e Dytë e Kosovës ka filluar më datë 17 tetor 1448, e cila sipas kalendarit julian ishte ditë e enjte,<sup>29</sup> por sipas kalendarit gregorian ishte ditë e martë. Bonfini në tekstin e tij si ditë të enjte.

Fjalimi, me të cilin Huniadi u drejtohet luftëtarëve të tij, është pa dyshim një ndër më të bukurit që ngre peshë zemrat e tyre. Ai karakterizohet nga sinqeriteti i pranimit të gabimeve të së kaluarës, ku beteja e Varnës luan një rol të rëndësishëm, për shkak të lidhjeve emocionale dhe shpirtërore që kanë ushtarët me këtë betejë.

<sup>27</sup> Alain Ducellier, "La façade martitime de la principauté de Kastriote, de la fin du XIV<sup>e</sup> siècle à la mort de Scanderbeg", në: *Studia Albanica*, VI. (Tiranë, 1968): 119-136.

<sup>28</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Invitus in certamen Corvinus descendere cogitur, quando aqua ceteraque necessaria interdicebantur. Tandem in divi Lucae solennibus ac die Iovis exercitum armari iubet. Eumque in duo et triginta agmina dividit; munitiones omnes in colle adversus hostes parat et intendit. Acies sic instructas sacris deo servatori operari, mystica inter se confessione ac terrestri communionem uti imperat et in concione militem ad prelium hortatur.

<sup>29</sup> Edhe studiuesi Capelli e jep datën 17 tetor 1448 si ditë e enjte: Adriano Capelli, *Cronologia, Cronografia e Calendario Perpetuo dal principio dell'Éra Christiana ai nostri giorni. Tavole cronologico-sincrone e quadri sinottici per verificare le date storiche. Sesta edizione aggiornata*. Stampato da Legoprint S. r. L., Trento. (Milano: Editore Ulrico Hoepli, 1988): 41.

Humbjen dhe turpin e pësuar në këtë betejë, Huniadi i shndërron në arsye për hakmarrje dhe për reflektim për të ardhmen.

*Erdhi dita, miqtë e mi (u thotë ai), të merrni hak për humbjen, turpin dhe të gjitha të zezat që keni vuajtur në luftën e Varnës! Sot mund të fitoni emrin e mirë që keni pasur për besnikëri dhe trimëri. Nëse doni të jeni burra, ja ku e keni armikun, që ju ka shkaktuar kaq humbje! Edhe pse superiorë në numër, janë inferiorë në shpresë, në kauzë dhe në fuqi. Çfarë shprese kanë ata, që nuk luftojnë për perandorinë e tyre por për atë të një tjetri? Edhe pse fitimtarë, ata fitojnë edhe robëri në këtë jetë dhe torturë në jetën tjetër, dhe mizerje në të dyja jetët. Ju, që luftoni me trimëri për mbretërinë tuaj, për fëmijët tuaj, për atdheun tuaj, për vatrën dhe altarët tuaj, ju keni shpresë për lumturi të përjetshme dhe solide në të dyja jetët, çfarëdo që të jetë rezultati i betejës.<sup>30</sup>*

Po kështu, Huniadi jep një përshkrim real të situatës në të cilën gjenden, jo vetëm ata vetë fizikisht, por edhe familjet e tyre, duke kontekstualizuar kështu rrezikun real të pushtimit dhe domethënien që do të ketë ai në jetët e tyre. Vizioni i tij për të ardhmen dhe zbulimi para ushtarëve të tij i asaj që nuk duket me sytë fizikë, e bëjnë Huniadin të duket një udhëheqës i pjekur dhe i besueshëm për fitoren e betejës. Krahasimi i vazhdueshëm jo vetëm i forcave por edhe i fateve dhe syhapja për të parë atë që është e vështirë sidomos në situata ekstreme janë forca e vërtetë e këtij lideri.

*Kauzat tuaja janë shumë më të rëndësishme, sepse nëse nuk arrini të mundni armikun sot, siguria dhe pasuria juaj janë krejt të humbura. Ju i keni parë trimëritë e të dyja palëve më shumë se mjaftueshëm. Në Varna luftuam keq. Megjithatë, nëse do të kishte qenë e mundur të shkëmbeheshin fatet e të dyja palëve,<sup>31</sup> turku do të kishte preferuar ndoshta të shkëmbente kasaphanën e njerëzve të tij me luftën e tonëve (duke qenë se ai e pati të pamundur të*

<sup>30</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Venit tandem (inquit) dies, o socii, quo, si quid e Varnensi fuga dedecoris et ignominiae contraxistis, hodie pristinum fidei et virtutis vestrae nomen recuperare et acceptam cladem ulcisci licet. Si viri esse volueritis, e tot cladibus, quas a vobis accepit hostis, has vobis reliquias obiecit, que, etsi numero potiores, spe tamen causis et viribus multo inferiores. Quidnam illis sperare licet, qui non pro suo, sed alieno pugnant imperio et, dum vicerint, in hac servitutem et in altera cruciatum, in utraque vita perpetuam miseriam consequuntur? Vobis contra, utro se res vertat, pro regno vestro, pro liberis, pro patria, pro focis et aris sane pugnantibus aeternam ac solidam utriusque vite felicitatem sperare licet.

<sup>31</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Causae quoque vobis longe vehementiores, quippe qui nisi hostem fortissime cecideritis, de salute fortunisque vestris omnino est actum. Utrarumque vires explorete satis superque. Ad Varnam semel male pugnatum est, ubi, si partis quandoque utriusque.

*ndiqte arratisjen e armikut, sepse ishte i plagosur rëndë), por të vuante humbjen e kaq shumë njerëzve të tij. Ata pësuan më shumë dëme, kurse ju vuajtët më shumë turp, megjithëse ata i pësuan humbjet me anë të dhunës, ndërkohë që ju me dëshirë ju nënshtruat turpit nëpërmjet arratisë.<sup>32</sup>*

Huniadi vendos jo vetëm përgjegjësi mbi shpatullat e çdo ushtari nëpërmjet kontektualizimit të fitores dhe humbjes së ushtrisë së tyre dhe rëndësisë që kanë të dyja për jetën e secilit, por njëkohësisht edhe i lehtëson ata nga përgjegjësia e tepërt dhe rënduese, duke e hedhur peshën e saj mbi fatin dhe mbi fuqitë e mbinatyrshme që nuk mund të kontrollohen nga vetë njeriu. Në këtë kontekst, ai thërret ndihmën e Zotit dhe të Jezu Krishtit<sup>33</sup> për të arritur një fitore sa më të plotë dhe domethënëse.

*Në fakt, unë besoj që më shumë se frika juaj, ishin zotat e inatosur, ata që e shkaktuan atë katastrofë, duke qenë se ata donin të merrnin hak për besimin që ne u kishim dhunuar, sepse të gjithë autorët e asaj tradhëtie, me përjashitim të një njeriu, e paguan atje dënimin e tyre. Ne që erdhëm pa dëshirë në këtë luftë, jetojmë akoma me hir të Zotit, ruajtur për mbrojtjen e krishtërimin dhe veçanërisht të Hungarisë, nëse nuk na mposhtet bashkë me ne nga armët dhe zemërimi i turqve. Numri juaj nuk është për t'u trembur në asnjë mënyrë, sepse me pak ju shpesh keni luftuar dhe keni mposhtur shumë. Deri tani ne kemi luftuar me fuqi hyjnore më shumë sesa me fuqi njerëzore, dhe në emër të Jezusit, shpëtimtarit tonë, kemi shkatërruar lehtësisht çdo lloj ushtrie profane. Kudo ku kemi vënë këmbën, kemi hapur gjithmonë rrugën me armët tona të fuqishme në emrin e fuqishëm, sepse ne kemi luftuar me udhëheqje dhe mbrojtje hyjnore. Prandaj ndjejmë që Shpëtimtari i vdekatarëve dhe Nëna e Shenjtë kanë qenë gjithmonë me ne. Ne nuk besojmë se ato do të na braktisin sot, nëse ne jemi të ndërgjegjshëm për mëshirën dhe virtytin hyjnor. Zoti është gjithmonë ndihmësi i atyre që luftojnë shenjtë dhe me trimëri. Për*

<sup>32</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Ad Varnam semel male pugnatum est, ubi, si partis quandoque utriusque (f. 473) fortunam commutare liceret, maluisset fortasse Turca suorum caedem cum nostrorum fuga commutare (quum fugientes insequi nequiverit gravissime caesus) quam tot suarum gentium fecisse iacturam. Illis plus detrimenti, vobis plus turpitudinis illatum, quamvis illi vi coacti damna, vos ultro fuge ignominiam subiulistis.

<sup>33</sup> Giuseppe Valentini S. J., Matteo Sciambra, Ignazio Parrino, *Il "Liber Brevium di Calisto III la Crociata, l'Albania e Skanderbeg. Descrizione, introduzione, edizione in regesto e parzialmente integra, e indici.* /Centro Internazionale di Studi Albanesi-Palermo; Istituto Universitario Orientale Napoli; Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma; Fondazione Giorgio Cini-Venezia; Pontificum Institutum Orientalium Studiorum-Roma/. (Palermo: Scuola Grafica Salesiana, Palermo, 1968).

*më tepër, ne kemi një mënyrë të sigurt të luftimit, kalorësinë e rëndë e cila është si një force që nuk mund të mposhtet në një kështjellë të fortifikuar. Këto mbrojtës janë ushtarët tanë, të cilët janë edhe lehtësisht të drejtueshëm dhe të mjaftueshëm për të mposhtur armikun: turma e madhe është konfuze.*<sup>34</sup>

Sigurisht që këto fjalime të krijuara nga Bonfini, të paktën në mënyrën se si i lexojmë ne sot në këtë përkthim, edhe pse disa nga idetë mund të jenë përdorur edhe nga Huniadi, gjë që treguesit e historive orale gjithmonë i përmendin me kënaqësi dhe me krenari, paçka se aty këtu mund të kenë shtuar edhe versionin e tyre të këtij fjalimi.

*Fjalimi i guvernatorit i kishte ngritur peshë shpirtrat e të gjithëve, dhe të gjithë ishin të frymëzuar mjaftueshëm nga fjalët e tyre dhe natyra e tyre për të luftuar me trimëri. Edhe mbreti Murat po e organizonte dhe forconte ushtrinë e tij me fjalë, premtime dhe urdhra. Ushtria turke ishte udhëhequr dhe përhapur në të gjithë fushën, duke prekur të dyja anët e maleve. Kjo gjë i kishte mbushur të krishterët me një habi jo të vogël. Në orën e tretë të ditës, ai urdhëroi të jepej sinjali për betejë.*<sup>35</sup>

Bonfini e përshkruan betejën me shumë objektivitet, duke i mbajtur në minimum zbulime me heroizma dhe tragjizma në të. Duhet të kemi parasysh që karakteristikë e humanistëve është përshkrimi i ndjenjave të personazheve dhe zgjimi i tyre te lexuesi duke përdorur shumë dhe gjuhën heroike.

<sup>34</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 472: Nam perfidiae illius auctores, ad unum omnes, capitales illic poenas exolvere. Nos, qui inviti ad id bellum venimus, una vobiscum adhuc divina benignitate vivimus ad Christianae rei publicae tutelam reservati et imprimis Ungarie, ne Turcarum armis ac rabie obrueretur nobiscum. Numerus vobis nequaquam reformidandus, quando cum multis pauci saepissime pugnare ac vincere dedicistis. Divinis potius quam humanis viribus hucusque dimicavimus, in nomine Iesu servatoris nostri prophanas facile acies dissipavimus. Quocunque pedem tulimus, in praepotenti nomine victricibus semper armis viam aperuimus, quia divino ductu et auspiciis militavimus; hinc mortalium servatorem, hinc divam genitricem semper nobis affuisse sensimus. Neque hodie nobis defore credimus, si coelestis charitatis et virtutis vestrae memores esse volueritis. Adiutor deus semper adest sancte ac strenue dimicantibus. Accedit tutus pugnandi modus, cataphractorum equitatus, qui in arcis munitae speciem haud facile expugnari potest. Cohortes hae sunt nobis militum, quae et facile regi et hostibus sat esse videantur; innumera multitudo confunditur.

<sup>35</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 473: Accensi sunt admodum gubernatoris oratione cunctorum animi et ad strenue dimicandum verbis ac suapte natura, sat animati omnes. Ne minus quidem impigre Amurathes rex contra in ordines redigebat exercitum et dictis, promissis ac iussibus obfirmabat. Educte Turcorum acies et in planitiem effuse, latus utrunque montium attingebant. Unde haud parum Christianis stuporis incusserant. Tertia hora diei signa inferri iubet.

Bonfini thjesht jep formacionet ushtarake dhe pozicionet e tyre si dhe strategjitë e përdorura në betejë, duke u përpjekur të jetë sa më konçiz dhe i përqendruar.

*Korvini kishte dërguar rreshta të gjatë flamurtarësh nga të dyja anët e kodrës, që arrinin deri në qendër të fushës. Në qendër kishte vendosur Zekielin, kunatin e tij, me një flamur katror të kalorësisë së rëndë në kodër, kishte fortifikuar garnizonet dhe kampin me karroca luftarake. Sapo u dha sinjali për betejë, ushtarët që ishin përgatitur shpirtërisht dhe fizikisht, filluan me furi betejën nga distanca, dhe pastaj me fatin që po i favorizonte nga të dyja anët, filluan një sulm nga një distancë e vogël. Ata luftuan me shumë furi për rreth tre orë; pastaj vija turke u dobësua nga Benedikt Losoncio, i cili kishte komandën në krahun e djathtë. Edhe Stefan Banfi, që ishte në të majtë, nuk ishte më pak luftarak në veprimet e tij, dhe kishte shkaktuar shumë dëme mbi armikun kokëfortë të Evropës. Kur Murati pa që njerëzit e tij po humbnin kontrollin në të dy anët, dërgoi përforcime të reja dhe rifilloi betejën.<sup>36</sup> Duke qenë se ishin mjaft të lodhur nga sulmi i papritur i turqve, hungarezët dhe vllahët me kalorësinë e tyre të shpejtë u tërhoqën në radhët e kalorësisë së rëndë, të cilët, duke qëndruar si mur, i prisnin lehtë edhe gjuajtjet më të forta të armikut. Shumë ranë nga të dyja anët, por shumë më tepër turq, ngaqë ata nuk ishin të pajisur me të tilla armë dhe me të tillë fuqi të kuajve. Nga kodra, Korvini mposhti dhe shpërndau tërësisht të gjithë turqit nga fortifikimet që kishte synuar. Kur Murati e pa këtë gjë, i lëvizi radhët drejt kodrës dhe i detyroi ata të merrnin pa nevojë gjuajtjet e artilerisë nga lart. Në këtë mënyrë puna e fortifikimeve doli e pavlerë. Kur Korvini e kuptoi këtë, iu bashkëngjiti me shpirt atyre që po përpiqeshin t'i ndihmonin, duke ofruar përforcime nga të dyja anët, herë me zërin e tij e herë me duart e tij. Ai u jepte ndihmë të lodhurve, u jepte zemër të tremburve, rikthente në radhë të arratisurit, dhe paraprinte bashkë me ata që ishin në radhët e para. Ai nuk lë asgjë mangët*

<sup>36</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 473: Corvinus utraque ex colle ad plana cornua demiserat longasque utrinque vexillationum alas, a fronte protenderat. In medio Zechelem e sorore fratrem cum quadrato agmine cataphractorum collocarat; in colle presidia curribus munitioibusque obfirmarat. Dato pugne signo milites, qui animos corporaque, curarant, ardentis eminus, primo pugnam ineunt, deinde adaucta blandiente fortuna utrinque audacia magno cominus impetu (f. 474) congregi cepere. Tribus circiter horis acerrime pugnatum; deinde Turcorum acies a Benedicto Losoncio, qui in dextro cornu preerat, inclinata. Et a Stephano Banffi, qui in sinistro erat, ne minus quidem impigre agebatur, quippe qui basseum Europe pertinacius instantem multis plane cedibus affecerat. Amurathes nutantes in utroque cornu suos conspicatus valida submittit auxilia preliumque instaurat.

*nga detyra e komandantit dhe ushtarit të mirë; herë duke inkurajuar dhe duke lavdëruar trimat, herë duke qortuar dhe frikësuar frikacakët, ai ishte kudo i pranishëm.*<sup>37</sup>

Ndërkohë që vazhdon të përshkruajë rrjedhën e betejës, Bonfini, ashtu si humanistët e tjerë të shekullit të pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë, nuk lë pa përmendur edhe zotat paganë, siç do ta shohim në vijim, dhe konkretisht Marsin si zot të luftës.

*Kudo ku digjej puna e Marsit, dukej që gjërat qelbeshin me gjak. Murati urdhëroi përforcime të reja dhe nuk i bëri përshtypje humbja e të tijve, duke i besuar fuqisë së turmës, për të cilët ishte e sigurt që po luftonin mirë. Padyshim që ai shpresonte që armiku të lodhej dhe të dobësohej nga vazhdimësia e përforcimeve, dhe nuk ishte gabuar në shpresën e tij: një hungarez ishte i detyruar të luftonte kundër katër-pesë ushtarëve turq, para se t'i vinin përforcimet. Ata hanin drekën, darkën, freskonin trupin me ushqime të shpejta duke luftuar në betejë. Radhët e turqve shtoheshin gjithandej, shpesh deri në kamp. Hungarezët luftonin mirë, duke vrarë një numër të madh turqish, megjithatë, edhe pse të krishterët ishin superiorë në betejë atë ditë, beteja luftohej me zemërluanë nga të dyja anët dhe të dyja anët kishin vendosur: ose të fitonin ose të vdisnin. Lufta vazhdoi deri vonë, derisa nata e ndërpreu atë. Të dyja palët u tërhoqën në kampet e tyre me mendjen që do ta rifillonin betejën ditën tjetër: asnjëra palë nuk e kthente kurrizin, derisa e drejta për të komanduar u vendos nga Marsi si gjykatës. Atë natë nuk fjeti askush. Të dyja kampet vigjiloheshin me roje nate.*<sup>38</sup>

<sup>37</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 474: Ungari et Valachi expeditissimi equitatus irruentibus denuo Turcis haud parum defatigati ad cataphractorum ordines se receperunt, qui veluti pro muro stantes maximos quosque hostium impetus facile excipiebant. Multi utrinque cadunt, sed e Turcis longe plures, quando nec talibus armis nec eo equorum robore sese muniunt. Corvinus a colle munitionibus, quas intenderat, procul Turcas obterit dissipatque. Quod quum Amurathes vidisset, quantum fieri potuit, suas acies colli admovit subegitque, ut iritos ab alto machinarum ictus exciperet. Hac igitur arte munitionum elusa est opera. Hoc ubi a Corvino intellectum est, ad succurrendum laborantibus animum adiecit; suggerit utrique cornu subsidia, nunc voce, nunc manu rem agit. Suppeditat fessis auxilium, trepidantibus inclamitat, fugientes in ordinem revocat, acerrime irruentibus occurrit nihil ex optimi imperatoris et militis officio remittit; nunc fortes hortatur et laudat, nunc corripit ignavos et territat; omnibus presto adest.

<sup>38</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 474: Quare ita fervet ubique Martis opus, ut cuncta sanguine foeda conspiceres. Amurathes subsidia crebra acciri iubet, neque suorum cede consternatur multitudinem magna fretus, cui rite pugnare certum erat. Haud dubie sperabat omnino se hostem longa subsidiorum successione defatigaturum neque spe sua falsus est; unum Ungarorum

Marrëdhënia e humanistëve me perënditë ishte komplekse dhe e ndërlikuar. Duke u gjendur në një proces kalimi nga botëkuptimi tradicional i krishterë në një rizbulim të kulturës antike që inspironte një mënyrë të re të të parit dhe të konceptuarit të botës, nga njëra anë, ata ishin të ndërgjegjshëm që zotat e antikitetit ishin produkte të kohës së tyre dhe nuk duheshin marrë si të vërtetë, por nga ana tjetër, ata shpesh u referoheshin zotave paganë, sikur ata të luanin vërtet një rol të rëndësishëm në fatet e mëdha të jetës dhe të universit.

Marsi, perëndia i luftës në mitologjinë romake, mishëronte zakonisht guximin, trimërinë dhe nderin, dhe shpesh përdoret në tekste humaniste thjesht si simbol i këtyre virtyeteve, por nuk mungojnë rastet kur ai nuk përdoret thjesht si simbol nga humanistët, por në mënyrë ambivalente, duke i veshur atij edhe rolin e gjykatësit të rezultateve të luftës, si dhe duke e lidhur atë direkt me dhunën dhe shkatërrimin që shkakton lufta. Edhe Bonfini e përdor në këtë kontekst në një mënyrë ambivalente.

*Të gjithë prisnin me frikë ditën në vazhdim, sikur po shkonin te Marsi, gjykatës i jetës dhe vdekjes. Pa zbardhur dita akoma, të dyja ushtritë dolën përpara njëra-tjetrës dhe beteja filloi. Hungarezët nuk luftonin më me zjarrin dhe me fuqinë e një dite më parë. Nuk kishte asnjë mes tyre që nuk kishte luftuar me fuqitë maksimale një ditë më parë. Kishin mbetur edhe dyzet mijë turq, të cilët ose nuk kishin zbritur akoma në betejë, ose sapo kishin filluar të luftonin. Megjithatë, Korvini i shoqëronte njerëzit e tij, që të mos e humbnin fitoren që kishin arritur ditën e mëparshme me anë të dembelisë dhe frikës, por të vazhdonin të fitonin siç kishin filluar. Ai u lutej atyre që të mos e linin në baltë vendin dhe veten e tyre. Ai u kujtonte atyre sa mirë kishin luftuar një ditë më parë dhe sa mijëra armiq kishin mposhtur, sa pak humbje kishin pasur dhe sa shumë kishin luftuar e fituar. U tregonte që të mos tërhiqeshin me turp dhe e gjithë djersa dhe gjaku që kishin derdhur deri në atë pikë të shkonte kot. U kujtonte se ata që kishin filluar gjëra kaq të mëdha ishin të denjë për*

agmen quatuor et quinque Turcorum acies ante lassare cogebatur, quam sibi subsidia rite succederent. In acie pransum et coenatum ambulatoriisque coenis refecta corpora. Eo die ubique Turcica acies inclinata, saepe in castra usque fugata; sat prospere ab Ungaris pugnatum, magnus Turcarum numerus caesus. Christiani quamvis eo die bello superiores essent, tamen ita obstinatis utrinque animis praelium agebatur, ut utriusque aut vincere aut mori omnino decreverint. Certamen ad serum usque productum; nox praelium diremit; utriusque se in castra recepere his animis, ut postero die pugnam instaurarent neutriusque terga verterent, donec ius imperandi Marte iudice definiretur, ea nox insomnis acta, utraque castra crebris vigiliarum stationibus obsita.

*lavdi, sidomos ata që i çonin deri në fund ato që kishin nisur. Ai u kujtonte atyre se çfarë humbjesh do të kishin nëse do të luftonin keq, para së gjithash llojet e ndryshme të vdekjes dhe torturat, si dhe skllavërinë e grave dhe të fëmijëve, shkatërrimin përfundimtar të mbretërisë, përdhunimin e virgjërshave, desakrimin e gjërave njerëzore dhe të shenjta dhe të gjithë të zezat e patregueshme. Ai u tregonte që të gjitha këto të zeza mund të evitoheshin nga puna e një dite të vetme. Për këtë arsye, ai u lutej dhe u përgjerohej duke u kujtuar besimin në Zot e në njerëz, që të çlironin veten, vendin e tyre, fëmijët e tyre, gratë e tyre dhe pasuritë e tyre dhe të siguronin lirinë e përjetshme të të gjitha gjërave që donin.*<sup>39</sup>

Në këtë fragment, historiani humanist Antonio Bonfini, na jep një pasqyrë të detajuar të betejës mes ushtrisë hungareze dhe asaj osmane. Ai fokusohet në aspektet psikologjike të luftës, në rolin e udhëheqësit në motivimin e trupave dhe në pasojat e mundshme të një fitimi ose humbjeje. Këtu Bonfini përdor një gamë të gjerë emocionesh për të motivuar ushtarët e tij: frikën, turpin, krenarinë, besimin në Zot. Ai luan me shpresat dhe frikërat e tyre për të siguruar një performancë më të mirë në betejë. Huniadi, i cili vazhdon të quhet ‘Korvin’ gjatë gjithë historisë së Bonfini, shfaqet si një udhëheqës karizmatik dhe inspirues. Ai e njuh mirë psikologjinë e ushtarëve të tij dhe përdor një retorikë efektive për t’i mobilizuar ata.

Bonfini paraqet një tablo të zymtë të pasojave të humbjes, duke theksuar vuajtjet e popullsisë civile dhe shkatërrimin e vendit, një taktikë e zakonshme

<sup>39</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 474: In sequentem omnes diem solliciti expectabant veluti Martem sue vite mortisque arbitrum adituri, vix dum illuxit, quum utrinque instructae acies adfuere, redintegratur praelium, sed ab Ungaris, ne eo quidem ardore ac robore, quo superiore die, pugnatum est; nemo ex his fuit, qui extremis pridie viribus non dimicavit. Quadraginta fere Turcorum milia superfuerant, quae aut in certamen non descenderant aut levi praelio luserant. Corvinus tamen suos hortatur, ne initam superiori die victoriam per desidiam et ignaviam interciperent, pergerent vincere, ut occoeperint; item obsecrare ne sibi patriaeque desint; considerent, pridie quam bene pugnarint, quot hostium milia pauci protriverint, quotiens inclinarint et fuderint, praecaveant, ad extremum turpiter ilia ducant et sudores hactenus effusos tolerataque pericula omnia sint irrita habituri; non qui magna occoeperint, sed, qui coepta pulcherrime terminarint, hos gloria dignos existimari putent; praeponant ante oculos, quaecunque ipsos detrimenta manebunt, si male dimicarint; in primis varia mortis et cruciatu genera, item servitutem matronarum liberorumque, ultima regni excidia, raptus virginum et humanarum divinarumque incestationes infandaque piacula affirmare; haec omnia unius diei labore evitari posse; proinde orare et obtestari per deum hominumque fidem, ut solita se, patriam, liberos, coniuges et fortunas virtute redimant et in perpetuam libertatem cuncta vindicent.

kjo në propagandën e luftës, që shërben për të inkurajuar ushtarët të luftojnë me më shumë vendosmëri. Feja luan një rol të rëndësishëm në motivimin e ushtarëve, prandaj Bonfini u bën thirrje ushtarëve të besojnë në Zot dhe të luftojnë për mbrojtjen e krishterimit. Në shekullin e pesëmbëdhjetë, psikologjia luante një rol të rëndësishëm në luftë dhe udhëheqësit përdornin një gamë të gjerë teknikash për të motivuar ushtarët e tyre dhe për të fituar betejën.

*Edhe Murati i nxiste njerëzit e tij me shpërblime, premtime dhe kërcënime, në mënyrë të tillë që ata më mirë të duronin çdo gjë sesa të mallkonin Evropën në atë ditë. Ai i mbikëqyrte të dyja anët dhe i detyronte të gjithë të luftonin me fjalimet më të rënda.<sup>40</sup> Kur të dyja palët u përplasën në betejë, ata luftuan me po aq ashpërsi dhe këmbëngulje sa ditën paraprake. Shumë nga të krishterët e lënduar u kthyen në betejë<sup>41</sup> duke lënguar nga plagët dhe duke kërkuar ose vdekjen ose fitoren, por duke luftuar jo më pak se ditën e mëparshme. Një kasaphanë e madhe u krijua gjithandej dhe vrulli i hungarezëve nuk mund të shahet. Turqit, edhe pse rezistuan me të njëjtën kokëfortësi, nuk mundeshin t'u bënë ballë. Kalorësia e tyre shumë e shpejtë dhe e freskët filloi të mbizotëronte forcën e tyre të pathyeshme me dinakëri. Kur hungarezët u sulën mbi ta, ata kthenin menjëherë kurrizin, duke i bërë ata që t'i ndiqnin për ca kohë; duke u shpërndarë gjithandej, ata largoheshin duke lejuar që të ndiqen larg dhe gjithandej. Këta, si të shtyrë nga një fitore që po u buzëqeshte, vraponin pas tyre, duke shkaktuar rënien e shumë prej tyre në betejë. Të tjerët, pasi kishin marrë sinjal, mblidheshin në një formacion të ngushtë, i rrethonin dhe i shkatërronin radhët duke shkaktuar kasaphanë të madhe dhe duke i rraskapitur forcat e Panonisë në avantazhin dhe tërheqjen e tyre, duke i mposhtur me dinakëri fuqitë e tyre dhe duke luftuar pa ndërprerje gjatë gjithë ditës me rrangjet e tyre që ishin të paorganizuar. Një kasaphanë e madhe u bë ndër hungarezët atë ditë dhe turqit ishin superiorë. Nata dhe lodhja e përfunduan betejën me të dyja ushtritë e rraskapitura. Të dyja ushtritë u tërhoqën në kampet e tyre dhe filluan detyrën rojet në turne nëpër kampe.<sup>42</sup>*

<sup>40</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 474: Nihilò secius Amórathes suos præmiis, pollicitationibus ac minis incendit, ut omnia perpeti quam eo die Europa cedere maluerit. Lustrat utrunque cornu et gravissimis cunctos dictis ad pugnandum hortatur. At, ubi collatis utrinque signis concurrere, ne minore quidem ferocia impetuque, quam superiore die, pugnatur.

<sup>41</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 474: At, ubi collatis utrinque signis concurrere, ne minore quidem ferocia impetuque, quam superiore die, pugnatur. E Christianis quam plurimi e sauciis in aciem rediere.

<sup>42</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 475: E Christianis quam plurimi e sauciis in aciem rediere suscepta dudum vulnera aut morte, aut victoria curaturi; nihilò tamen segnius pugnassee dicuntur.

Nëse në fragmentin paraprak Bonfini fokusohet më shumë në aspektet psikologjike të luftës dhe në rolin e udhëheqësit, në këtë fragment ai thekson më shumë aspektet taktike dhe fizike të betejës. Të dy fragmentet megjithatë plotësojnë njëra-tjetrën, ofrojnë perspektiva të ndryshme mbi të njëjtin ngjarje, duke thënë një pasqyrë të detajuar të betejës. Këtu Bonfini fokusohet në taktikat ushtarake të të dy palëve, duke theksuar këmbënguljen dhe vendosmërinë e të dy ushtrive, edhe pse në fund turqit dalin fitimtarë falë taktikave të tyre më të zgjuara, si tërheqja dhe rrethimi për të lodhur dhe për të mposhtur forcat e kundërshtarit. Të dyja palët demonstrojnë vendosmëri të madhe në betejë, ku bie në sy fakti që edhe ushtarët e plagosur kthehen për të luftuar, duke treguar një shpirt të patundur. Lodhja luan një rol të rëndësishëm në rezultatin e betejës. Turqit, duke qenë më të freskët, arrijnë të shfrytëzojnë lodhjen e kundërshtarit për të fituar. Bonfini nuk heziton të përshkruajë brutalitetin e luftës. Fjala “kasaphanë” përdoret disa herë për të theksuar ashpërsinë e betejës.

*Kur arritën ditën e shtunë dhe asnjëra palë nuk kishte fituar, filloi përsëri beteja që me ag. Kunati i Korvinit, komandanti i vllahëve, ishte i pari që përparoi në betejë me kalorësinë e tij shumë të shpejtë. Fisnikët e tjerë e ndoqën dhe formuan radhët në të njëjtën mënyrë. Kur beteja rifilloi, luftuan për ca kohë me të njëjtën shpresë. Një kasaphanë e madhe u krijua gjithandej dhe veçanërisht ndër hungarezë, të cilët të lodhur nga lufta e gjatë dhe nga plagët e rënda, kishin qenë të detyruar të luftonin pa pushim për tre ditë me radhë në betejë, duke qenë se numri i tyre ishte shumë i vogël. Zechel, i cili po luftonte me shumë qëndrueshmëri në radhën e parë, ishte i pari komandant legjionar që ra në duart e armiqve të shumtë. Emerik Marsalius dhe Stefan Banfi u rrethuan dhe u ekzekutuan nga turqit në mes të betejës. Kur Murati pa që luftëtarët që ishin në radhë të parë me Zechelin e kapur dhe të vrarë, filluan të kthejnë kurrizin dhe të largohen, urdhëroi menjëherë të gjitha forcat në*

---

Magna ubique cedes oboritur et Ungarorum impetus nusquam repelli poterat, quos cum pari pertinacia Turcae reiicere haudquaquam possent, arte robur indomitum eludere expeditissimi ac recentes eorum equitatus occoepere. Irruentibus in se Ungaris mox terga vertebant a tergo aliquantisper insequi et instare patiebantur, palantes et diffusi fugiebant sequi late dissipabant. Hi veluti arridente victoria pellecti impensius insequi, multos in fuga cedere, contra illi dato signo conglobati dissipatos circumvenire ordines et multa caede conficere, in cursu et recurso Pannonicas lassare vires, ingentes conatus eludere et perturbatis ordinibus toto die sine aliqua intermissione dimicare. Magna Ungarorum ea die patrata caedes et Turcae fuere superiores; defatigato utrinque exercitu nox et lassitudo praelium diremit. Utrique se in castra revocarunt, vigilie stationesque summo studio in castris habitae.

*kamp që t'u hidheshin sipër të krishterëve, dhe t'i shpartallonin ata që kishin mbetur të rraskapitur.*<sup>43</sup>

Ky fragment plotëson pamjen e përgjithshme të betejës, duke treguar se si një betejë e gjatë dhe e lodhshme mund të vendosë rezultatin përfundimtar. Nëse në fragmentet e mëparshme fokusoheshim në taktikat ushtarake dhe në rolin e udhëheqësit, në këtë fragment theksohet rëndësia e faktorëve si lodhja, morali dhe humbja e komandantëve. Autori vazhdon të na japë një pasqyrë të detajuar të betejës, duke theksuar këtë herë rëndësinë e lodhjes dhe të humbjes së komandantëve në rezultatin e përfundimtar të betejës.

Hungarezët, të lodhur nga tri ditë betejë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, në numër disa herë më të vogël se kundërshtari i tyre,<sup>44</sup> filluan të humbasin forcën dhe moralin. Rënia e komandantëve të ushtrisë hungareze e përshpejtoi këtë proces, sidomos ajo e Zekelit, Emerik Marsaliusit dhe Stefan Banfit ka një ndikim të madh në moralin e ushtrisë hungareze, gjë që tregon qartë se si humbja e udhëheqësve mund të çojë në një kolaps të ushtrisë. Sulltan Murati demonstroi aftësi të shkëlqyera strategjike duke shfrytëzuar dobësinë e kundërshtarit. Ai urdhëroi një sulm masiv në momentin kur hungarezët janë të lodhur, të dërrmuar e të plagosur, por edhe më të dobët fizikisht e shpirtërisht nga humbjet e mëdha që po pësonin gjatë tre ditëve radhazi.

*Kur u shpall edikti i mbretit, që të gjithë duhet t'i suleshin armikut së bashku, të dyja anët e hungarezëve, ku të gjithë po luftonin, u sulmuan menjëherë dhe beteja rifilloi edhe një herë: fisnikët u therën, të mbuluar nga një sasi e madh shigjetash, ca u zunë rob, dhe të gjitha radhët e tyre ranë në kaos. Kur Korvini mësoi që edhe kunati i tij ishte vrarë, të tjerë luftëtarë ishin zënë*

<sup>43</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 475: Quum ad diem sabbati pervenissent neuterque cederet, prima luce pugna redintegratur. Corvini frater Valachorum praefectus, cum expeditissimo equitatu primis in aciem prodiit. Secuti sunt reliqui proceres et eodem modo ordines instaurarunt. Reparato certamine aliquandiu spe pari dimicatum; magna ubique strages oborta et praesertim Ungarorum, qui longo bello defatigati multisque confossi vulneribus, triduo in acie, ob ipsam paucitatem perstare cogebantur. Zechel in primo ordine obstinatissime pugnans e praefectis legionum primus, inter confertissimos hostes occubuit. Emericus Marsalius, Stephanusque Banffi a Turcis circumventi in medio acie trucidantur. Quum Amurathes iam prima signa, que in Zechelis agmine constiterant, iam esse capta et caeso prefecto, milites terga vertisse conspicaretur, extemplo omnes, quecunque in castris acies forent, in Christianos edixit effundi, ut paucos et triduo labore confectos obruerent.

<sup>44</sup> Përsa i përket shifrave të pjesëmarrësve në këtë luftë sipas burimeve të ndryshme shih edhe Emanuel Constantin Antoche, "Hunyadi's Campaign of 1448 and the Second Battle of Kosovo Polje (October 17-20), in *Reconfiguring the Fifteenth-Century Crusade*, edited by Norman Housley. (Palgrave Macmillan, 2017): 245-284.

*rob dhe që e gjithë ushtria kishte marrë arratinë, e la kampin menjëherë, hipi në një kalë e nxitoi të arratisej, që të mos e linte mbretërinë pa guvernatorin e saj besnik. Turqit i ndoqën dhe i shpartalluan hungarezët e mbetur që nga mesi i ditës deri vonë në mbrëmje, pastaj, të verbuar nga errësira, u kthyen në kampin e tyre për të kaluar natën. Të tjerët që kishin mbetur në betejë rrethuan kampin hungarez dhe masakruan të gjithë që kishin mbetur aty, edhe të lënduarit, megjithëse ata luftuan deri në vdekje dhe nuk e lejuan armikun deri në shigjetën dhe në armën e fundit. Asnjë hungarez nuk u gjet pa trekatër trupa turq mbi trupin e vet. Murati që nuk donte të zbulohej kasaphana e njerëzve të tij, urdhëroi menjëherë që fisnikët të varroseshin, por trupat e ushtarëve të thjeshtë të hidheshin në lumë. Për këtë arsye, banorët përgjatë brigjeve të lumit Skithnicë nuk peshkuan më për shumë kohë. Kjo fushë është edhe sot e kësaj dite e mbuluar me kocka, si një tokë shkëmbore, dhe nuk mund të punohet pa gjetur shpesh armë. Ky vend u bë i famshëm për shkak të kësaj gjakderdhjeje të madhe.<sup>45</sup>*

Ky fragment është paraqitur nga Bonfini në mënyrë reale dhe plotëson pamjen e përgjithshme të betejës, duke treguar se si një fillim premtues për hungarezët, përfundoi në një katastrofë të paimagjinueshme. Bonfini thekson pasojat e një humbje të madhe dhe të përgjithshme, respektivisht shkatërrimin e plotë të ushtrisë hungareze. Fisnikët vriten, flamujt kapen dhe ushtria shpërndahet duke u arratisur nga koka këmbët. Rënia e komandantëve kryesorë siç ishin kunati i Janosh Huniadit, çoi në një kolaps të plotë të ushtrisë hungareze, gjë që pasohet nga një brutalitet i paparë i betejës dhe nga

<sup>45</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 475: Promulgato tunc regis edicto, ut omnes in hostes una ruerent, utrunque Ungarorum cornu, ubi cuncti laborabant, confestim obducunt, praelium instaurant, caeduntur proceres, a numerosa multitudine et sagittarum imbribus obruuntur, capiuntur signa et in fugam omnes ordines plane vertuntur. At, ubi Corvinus fratrem interfectum, capta signa nonnulla et versum in fugam exercitum accepit, continuo relictis castris impedimentisque consensu fugam equo solus praeripit, ne fida regnum tutela privaret. Fusos fugatosque Ungaros a meridie ad intempestam usque noctem hostes insequuntur et caedunt, mox a tenebris remorati in castra per noctem rediere. Ceteri, qui in acie remanserant, Ungarica castra circumvenerant, in quibus, quicquid calonum fuit et lixarum, item essendariorum, ac censorum sauciaequaeque turbae, quamvis ad mortem usque cetassent neque hostem admitterent, quousque minima sagitta telumque superfuit, ad unum tamen omnes trucidati sunt nullusque in castris ungarus est agnitus, quem tria quatuorve Turcarum cadavera non attingerent. Amorathes, ne maxima suorum caedes extaret, nobilium continuo sepeliri, gregariorum vero militum corpora, in profluentem proiici statim edixit. Quare Schithnizae fluminis accolae, diu eius piscibus abstinere. In saxorum morem campus adhuc ossibus opertus est, terra coli citra crebram armorum inventionem ullo pacto nequit. Locus ex insigni clade illustris est habitus.

masakër e jashtëzakonshme e të burgosurve: fusha e betejës mbulohet me kufoma dhe bëhet një vend i famshëm për shkak të kësaj masakre të përgjakshme.

*Megjithëse turqit dolën fitimtarë nga beteja jashtëzakonisht e përgjakshme me shkatërrimin dhe arratisjen e armikut, humbjet e tyre ishin shumë më të mëdha sesa ato të hungarezëve, duke qenë se u raportua që dyzet e tre mijë turq u therën, në krahasim me të krishterë që ishin vetëm tetë mijë të vranë. E gjithë fisnikëria hungareze ra aty në atë fushëbetejë. U vranë dy Emerikët, Ladislaus, Thomas Zeech, bani Franciscus, Jan Zechel, vëllai nga motra i Korvinit, Lossoncius, Stefan Banfi, legati apostolic, ipeshkvi i Koronës, Georg Chiach, Robert Char, dhe një sasi e panumërueshme fisnikësh të tjerë. Shumë u zunë rob dhe u ekzekutuan ditën tjetër me urdhër të Muratit. Jan Korothna u zu rob dhe u transportua në Azi, ku duroi gjashtë muaj skllavëri në Bursa, përpara se ta kthenin në Panoni nëpërmjet Dalmacisë, pasi kapërceu detin Egje, Kretën, Jonin dhe Adriatikun. Murai u raportoi korintasve po atë muaj që kishte shpartalluar tetë mijë hungarezë në këtë betejë.<sup>46</sup>*

Kjo betejë shënon fillimin e një periudhe të gjatë të luftës dhe pushtimit osman të Hungarisë. Të dyja palët pësuan humbje të mëdha, por humbjet e aristokracisë hungareze ishin veçanërisht të rënda, që do të kishte pasoja afatgjata për stabilitetin e mbretërisë hungareze. Fragmenti përshkruan vuajtjet dhe torturat që kaloi Jan Korothna i zënë rob në Azi.<sup>47</sup>

*Ata që arritën të shpëtojnë duke u arratisur nëpër Iliri dhe Dalmaci u kthyen shëndoshë e mirë, kurse ata që u kthyen nëpër Rasha, përmes rrugës*

<sup>46</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 475: Quamvis Turcae cruentissima victoria cesserit fuis fugatisque hostibus, eorum tamen caedes multo maior quam Ungarorum, quippe cum Turcarum quatuor et triginta hominum milia, Christianorum tantum octo milia caesa referuntur. Universa hic Pannoniae nobilitas occubuit. Nam hic Emerici duo, Ladislaus, Thomas Zeech, Franciscus banus, Ioannes Zechel Corvini e sorore frater, Lossoncius, Stephanus Banffi, episcopus Coronensis legatus apostolicus, Georgius Chiach et Robertus Char innumerique proceres ac nobiles opetiere. Multi capti et ante Amurathem postero die ex edicto obruncati. Ioannes Corothna quoque captus est in Asiamque translatus, Byrse servitium semester perpassus mox Aegeum, Creticum, Ionium Adriaticumque pelagus emensus per Dalmatiam in Pannonias se recepit. Octo Ungarorum milia in hoc bello caesa Corinthiis Amurathes eodem mense significavit.

<sup>47</sup> Francisc Pall, "I raporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV. (*Documenti inediti con introuzione e note storico-critiche*)", në: *Archivio Storico per le Province Napoletane*. Publicasto a cura della Societa Napoletana di Stoiria Patria. Terza serie. Anno IV, LXXXIII dell'intera collezione. (Napoli: Società Napoletana di Storia Patria 1966), ser. III, vëll. LXXXIII: 123-226.

nga e cila kishin ardhur, e gjetën provincën të mbushur gjithandej me banditë dhe vetëm pak arritën të shpëtojnë pa u zënë rob ose pa u vrarë.<sup>48</sup> Korvini, për të cilin thamë që iku shumë shpejt, u përball me një fat të keq dhe të pasigurt. Tre ditë me radhë udhëtoi mbi kalë pa bukë e pa ujë nëpër vende të pabanuara. Ditën e katërt u ndesh me dy banditë, duke qenë se kishte humbur kalin, i cili kishte ngordhur nga lodhja e tepërt. Duke qenë se ishte i paarmatosur, u rrethua dhe u robërua. Pasi iu hoqën edhe ato rroba që i kishin mbetur në trup, banditët filluan të ziheshin me njëri-tjetrin për kryqin e artë që e kishte të varur në qafë. Ndërsa po shikonte rrotull për një mënyrë se si të arratisesh, i ra në sy shpata e njërit prej banditëve, të cilin e mori shpejt dhe sulmoi burrat që po ziheshin. Njërën e gjuajti me një goditje fatale duke e vrarë, dhe tjetri iku me vrap. Në këtë mënyrë, nga kjo mundësi që iu dha nëpërmjet kryqit, njeriu i shenjtë u çlirua nga robëria dhe vdekja. Sigurisht që kjo erdhi nga përkujdesja hyjnore, në mënyrë që ai që kishte luftuar në emër të shpëtimtarit të kryqëzuar të lirohej me ndihmën e kryqit.<sup>49</sup>

Ky fragment tregon një kthesë dramatike në historinë e Janosh Huniadit. Pas një humbje të madhe në betejë, ai përballlet me një situatë personale shumë të rrezikshme, i burgosur nga banditët. Kryqi, simbol i besimit të tij, luan një rol kyç në shpëtimin e tij,<sup>50</sup> gjë që e vë theksin në lidhjen e ngushtë midis besimit dhe fatit të hungarezët,<sup>51</sup> duke e interpretuar shpëtimin e Huniadit si një ndërhyrje hyjnore. Ky fragment sugjeron se Huniadi ishte një njeri i

<sup>48</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 476: Ex his qui evaserant, quincunque per Illyricum effugere, per Dalmatiam incolumes redierunt; qui per Rasciam, qua venerant, reverti contendere, sic infestam ubique latrocinii provinciam invenerere, ut pauci evaserint, qui aut spoliati aut caesi non fuerint.

<sup>49</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 476: Corvinus, quem expeditissimum aufugisse diximus, infestam ac variam fortunam invenit; dies tres equo invectus per avia loca iter facit, cibi et potus expers; quarto incidit in duos latrones dimisso dudum equo, qui pre nimio labore defecerat. Quum esset inermis, se spoliandum dedit; direptis vestibus ex aurea cruce, que e viri collo pendebat, inter latrones oborta contentio; dum salutis viam circumspicit, promptum sibi latronis gladium intuetur, quo mox rapto litigantes adoritur, alterum lethali vulnere conficit conculcatque; alterum petens in fugam vertit. Hac igitur crucis occasione vir sanctissimus se a rapina morteque redemit. Quod haud ab re divina benignitate factum, ut, qui pro cruce affixi servatoris nomine dimicaret, crucis quoque auxilio liberaretur.

<sup>50</sup> Ignatius Parrino, *Acta Albaniae Vaticana, Res Albaniae saeculorum XIV. et XV, atque cruciatam spectantia*. Tomus I. Studi e Testi, 266. Citta del Vaticano: Studi e Testi, 1971.

<sup>51</sup> Benevenuto Bughetti, "Documenta inedita de S. Bernardino Senensi, O.F.M. (1430-1445)", në: *Archivium Franciscanum Historicum, XXIX*. (Grottaferrata, 1936), 478-500, këtu 494, ref. 10.

fortë dhe i vendosur. Edhe në një situatë kaq të vështirë, ai nuk humb shpresën dhe gjen një mënyrë për të shpëtuar.

*Duke vazhduar rrugën i rraskapitur nga etja dhe uria, ditën e pestë u ndesh me një bari, i cili kishte dëgjuar për arratisjen e hungarezëve dhe po shpresonte të plaçkiste ndonjërin. Në fillim të dy mbetën si të ngrirë përballë njëri-tjetrit: bariu, kur pa pamjen mbretërore të Korvinit (siç lexojmë për banditët nga Scipio) nuk desh ta lëndonte. Edhe Korvini, i tretur nga uria, nuk kishte guxim ta sulmonte. Kështu, pasi u përshëndetën, filluan të bisedojnë pa dyshime me njëri-tjetrin. Njëri, jo pa ndërhyrjen e mëshirës hyjnore, i kërkoi bukë, tjetri kërkoi informacion për emrin dhe rrethanat e ngjarjes. Pasi kishte dëgjuar historinë e tij, bariu i prekur nga mëshira dhe i ngarkuar me premtimet e bëra, e drejtoi Korvinin për te kasollja më e afërt, ku i dha bukë, qepë dhe ujë. Më vonë, ky (Korvini) do të kujtonte që kurrë në jetën e tij nuk kishte ngrënë një darkë më të mirë.<sup>52</sup> Prej aty, ai u drejtua nga bariu për te rruga Synderovia, ku u zu rob nga komandanti i kështjellës me urdhër të despotit, sapo ky i fundit e mori vesh për Korvinin. Edhe pse i ishin bërë gjithë ato favore, ai ishte një njeri jomirënjohës. Për disa ditë debatuan për lirim të tij, por ai ra dakord që ta lironte vetëm nëse djali i tij, Matiasi, do të martohej me vajzën e despotit, mbesën e kontit Cilie, në mënyrë që të sigurohej realizimi i marrëveshjes nga të dyja palët. Përveç kësaj, Ladislaus, një djalë tjetër i Korvinit, duhet të jepej si peng. Guvernatori u lirua, pasi u dha peng, ashtu siç kërkohet.<sup>53</sup>*

<sup>52</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 476: Ultra progressus ac itinere, siti inediaque confectus quinto die pastorem offendit, qui audita Ungarorum fuga spe praedae late vagabatur; in primo ambo congressu constitere; pastor prospecta Corvini vultus maiestate (quemadmodum de latronibus et Scipione legimus), ab iniuria remoratur. Corvinus quoque fame iam absumptus hunc nequaquam audet adoriri. Mox consalutatione primum conciliati sine suspicione mutua inter se verba conserunt. Alter non sine divine charitatis prefatione panem exorat; nomen et casum alter percontatur. Audita viri fortuna pastor commiseratione percitus et promissis oneratus Corvinum in proximam casam ducit; panem cum cepis, aquam apponit hospiti, qui in iucunda sepe miserie memoria nunquam lautius se quam ibi coenasse affirmavit.

<sup>53</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 476: Hinc ad Synderoviam a pastore ductus est, ubi, posquam id despotes accepit, eius imperio a praefecto arcis capitur. Beneficiorum ille immemor perpetua ingratitude nota sugillatur. Dies aliquot de liberatione ibi agitatum; conventum tamen inter eos, ut ea gubernator condicione dimitteretur, uti Mathias eius filius despotis gnatam, comitis Cilie neptem uxorem duceret et, ut conventa utrinque tutius prestarentur, Ladislaus alter Corvini filius daretur obses. Proinde gubernator dato obside dimittitur.

Bonfini vazhdon të na tregojë për aventurat e pazakonta të Janosh Huniadit pas humbjes së betejës.<sup>54</sup> Ai thekson kontrastet e forta midis fatkeqësisë dhe mirësisë, si dhe rëndësinë e marrëdhënieve njerëzore në një botë të pasigurt. Pavarësisht situatës së pasigurt, bariu tregon një akt të madh mirësie dhe humanizmi duke e ndihmuar Huniadin. Për të shpëtuar jetën, ai detyrohet të bëjë një marrëveshje politike me Brankoviqin, duke lidhur një martesë midis familjeve të tyre, gjë që tregon se si situatat personale përdorshin për qëllime politike. Shoqëria e kohës ishte e ndarë në klasa të ndryshme, me një pabarazi të madhe të fuqisë dhe të pasurisë, dhe marrëdhëniet politike ishin shumë të ndërlikuara, ku martesat shpesh përdorshin si mjet për të forcuar aleancat.

*Në ditën e lindjes së shpëtimtarit tonë ai u kthye në Szeged, ku u prit me jo pak lëvdata nga një grup i madh fisnikësh dhe burrash të shquar që kishin dalë ta përshëndesnin. Ata të gjithë e uruan për kthimin e tij shëndoshë e mirë, duke e ngushëlluar në hidhërim dhe duke e i dhënë zemër e shpresë. Ata e siguruan që kishte qenë fat që kishin ende guvernatorin e tyre dhe që një sasi e madhe ushtarësh do t'i viheshin në dispozicion, si nga njerëzit e tij, ashtu edhe nga burime të jashtme. Askund në botë nuk mund të gjendej një udhëheqës si ai, nëse do ta kishin humbur atë. Kombit hungarez nuk i kishte ardhur turp nga kjo, sepse ata kishin luftuar me trimëri deri në njeriun e fundit, duke e lënë armikun me një fitore të përgjakshme dhe famëkeqe. Të gjithë njerëzit e tij që kishin vdekur, kishin pasur një vdekje fisnike; ata kishin luftuar pa pushim për tri ditë dhe kishin vrarë dyzet e tre mijë ushtarë të armikut me një ushtri të vogël kundër një turme të panumërt, ndërkohë që nga hungarezët vetëm tetë mijë. Në gjykimin e atyre që mendonin drejt dhe në mënyrë të paanshme, nuk mund të dëshirohej një fitore më e mirë.<sup>55</sup>*

<sup>54</sup> Vojislav S. Jovanović, “Sredovjekovni grad Zvečan. (Fortesse médiévale de Zvečan)“, në: *Starinar*. Nova Serija. Knjiga XIII-XIV /1962-1963/. Arheološki Institut. (Beograd, 1965): 137-150; këtu: 147, ref. 71.

<sup>55</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 476: In servatoris igitur nostri natalibus postliminio reversus in non parva procerum nobiliumque frequentia ad Segedinum recipitur. Certatim salutem incolumitatemque omnes congratulantur, tristem consolantur et bene sperare iubent; sat eis cum fortuna ben actum dicere, si gubernatorem receperint; militum adhuc copiam neque ex indigenis nec externis defuturam; talem se ducem nusquam gentium, si amisissent, reperturos; nihil hinc Ungarice genti turpitudinis accidisse, quando ad unum omnes strenue pugnarint, cruentissimam lacrymabilemque hostibus victoriam reliquerint; neminem suorum inventum, qui non pulcherrime occubuerit; triduo sine intermissione pugnatum et a paucis adversus innumeram multitudinem quattuor et triginta milia ex hostibus cecidisse, ex Ungaris vix octo considerati; paulo meliorem recte iudicantibus ac non iniqua petentibus victoriam optari posse.

Ky fragment përshkruan një kthesë interesante në narrativë. Pas një varg ngjarjesh tragjike, historia mbyllet me një notë optimiste dhe me një riinterpretim të humbjes si një fitore morale. Në vend që të shihej si një dështim, humbja e betejës është paraqitur si një fitore morale. Hungarezët janë përshkruar si heronj që kanë luftuar me trimëri deri në fund. Kthimi i Huniadit në Szeged<sup>56</sup> rikthen shpresën për unitet në vend dhe ai paraqitet si një figurë qendrore dhe e respektuar. Ky fragment ka një element të fortë propagandues, ku Bonfini përpiqet të justifikojë humbjen e betejës dhe të ngrejë moralin e popullit hungarez pas një disfate të rëndë e të përgjakshme dhe me viktima nga radhët e komandantëve, fisnikëve, udhëheqësve por edhe luftëtarëve të thjeshtë. Bonfini me mjeshtri shkruan në një moment shumë të vështirë për hungarezët, duke shprehur optimizmin se shoqëria hungareze e vlerësonte shumë trimërinë, besnikërinë dhe sakrificën e bijve të vet luftëtarë, por edhe të mercenarëve që ishin aleatë në këtë betejë, por që përfundojnë me humbje të dhimbshme. Edhe në kushtet e një humbjeje të madhe, ata arritën të gjejnë një arsye për të festuar dhe për të mbajtur lart moralin e ushtarëve dhe të popullit hungarez në përgjithësi, mënyrë e njohur dhe shumë herë e praktikuar nga popujt evropianë pas betejave të rënda e të përgjakshme, qofshin fitore apo humbje ato.

*Më në fund, të gjithë iu lutën seriozisht të ruante veten jo vetëm për veten e tij, por edhe për vendin e tij dhe për të gjithë krishterimin, të merrte zemër dhe të ishte këmbëngulës. Në këtë mënyrë, shpejt do t'i dënonte edhe turqit, ashtu edhe despotin, me dënime të merituar, dhe gjithçka do të përfundonte si mos më mirë. Korvini nuk gjeti asnjë ngushëllim në fjalët e fisnikëve.<sup>57</sup>*

Në këtë fragment, Bonfini shpreh tërë kreativitetin, zgjuarsinë, profesionalizmin dhe mjeshhtërinë e krijuesit, duke treguar presionin psikologjik dhe

<sup>56</sup> Shih letrën e J. Huniadit për guvernatorin *Nicolaum Decanum*, më datë 30 dhjetor 1448 (*Data Zegedini die penultima Decembris MCCCCXLVIII*), në: Ioannis Georgi Schwandtneri, *Scriptores rerum Hungaricarum veteres, ac genuini partim primum ex Bibliotheca Augusta Vindobonensi Eruti; partim antheac quidem editi, nunc vero ex rarissimis et optimis editionibus ab innumeris mendis indicati. Amplissima praefatione Mathiae Belii*. Tomus secundus. (Bibliopolae Vindobonensi: Imprensus Ioannis Pauli Kraus, 1746), vëll. II: 57-58, epistola (*letra*) XXXIX.

<sup>57</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 476: *Demum omnes eum impensius exorare, ut se sibi, patrie Christianaeque reipublice servare niteretur, revocaret animum et obfirmaret, quod si fecerit, per brevi ipsum et Turcam et despotem meritis utrunque poenis affecturum caeteraque prospere cessura. Corvinus procerum consolationibus haud parum confirmatus est. Angebat sibi animum, quod multo plures ex eo bello reduces quotidie videret, quam sperare liceret.*

vrasjen e ndërgjegjes së Huniadit pas humbjes së betejës, si dhe gjendjen e rënduar shpirtërore të tij pas disfatës së dytë me radhë nga turqit, pasojat e së cilës nuk i përballoi deri në vdekje. Ai përballlet me një dilemë të vështirë: a të vazhdojë luftën me një ushtri të dobësuar, apo të pranojë një lloj kompromisi. Fisnikët dhe ushtarët e inkurajojnë Huniadin të vazhdojë luftën, duke i premtuar besnikërinë e tyre. Huniadi është skeptik në lidhje me aftësinë e tij për të vazhduar luftën, veçanërisht pasi ka parë se shumë ushtarë po braktisin frontin në momente vendimtare të betejës, duke mos u treguar në nivelin dhe rolin që ata kishin marrë para se të niseshin për luftë. Pa mbështetjen e ushtrisë, ai nuk mund të vazhdonte të sundonte. Kjo tregon rëndësinë e marrëdhënies së besimit të ndërsjellë midis komandantit dhe ushtrisë në një shoqëri feudale mesjetare.

*Të gjithë ata që kishin ikur nga turqit përmes Ilirisë u kthyen shëndoshë e mirë, sepse në një distancë prej njëzetë mijë hapash kishin takuar Sando-robegun, i cili kishte ardhur për të ndihmuar me ushtrinë e tij, ndihma dhe udhëheqja e të cilit kishte mundësuar kthimin shëndoshë e mirë të tyre nëpër Iliri.<sup>58</sup>*

Rrëfimi i Bonfini na jep një pasqyrë të një ngjarjeje historike që lidh rrugët që përdorshin për t'u arratisur në kohë lufte dhe konfliktesh në Ballkan, si dhe rolin që luajti aleanca midis Huniadit dhe Skënderbeut në këtë moment.<sup>59</sup> Fragmenti thekson se ushtarët që kishin lënë fushëbetejën dhe ishin arratisur në Iliri, kishin gjetur siguri dhe mjete për t'u kthyer në shtëpitë e tyre. Kthimi i të ikurve nuk ishte një proces i rastësishëm. Ata u ndihmuan nga forcat ushtarake të Skënderbeut, gjë që tregon se kishte një organizim dhe

<sup>58</sup> Bonfini, *Decades III*, f. 476: Nam, quicumque ante Turcas in Illyricum aufugere, rediere incolumes, quin etiam ad viginti milia passuum Sandorobechum cum auxiliariis copiis occurrentem in itinere offendere, cuius occursu ductuque tuto sese in Illyricum recepere.

<sup>59</sup> Josephi Valentini, S.J., *Acta Albania Veneta. Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini, S.J. Labore reperta et transcripta ac typis mandata. Pars Tertia. Periodum Skanderbegianam complectens. Tomus *Vigesimus*. Annos a MCDXLVIII ad MCDL illustrans. Centro Internazionale Studi Albanesi "Rosolino Petrotta", Università, Palermo – Inst. Universitario Orientale, Napoli – Inst. Studi Albanesi Università, Roma – Fond. Giorgio Cini, Venezia – Pont. Ist. Studi Orientali, Roma – Albanien Inst. Universität München - Institut F. Geschichte U. Kultur D. Nachen Orients, Sowie F. Turkologie, Universität München – Südost Institut, München – Archivum Academie Scient. et Art Slavor. Merid., Zagreb – Monast. Eparch. S. M. Cryptoferr. (München: Rodulfo Trofeniko editore. – Monaci in Bavaria. Dr. Dr. Rudolf Trofenik - Verlag – Elisabethstr. 18. Impressus in Typographia Pont. Universitatis Georgiae – Roma, 1974): 58-61 dok. 5398, (10. X. 1448).

një përpjekje të koordinuar për këtë luftë të hungarezëve dhe shqiptarëve. Iliria, që nënkupton territoret e sotme shqiptare, si destinacion i kësaj lëvizjeje, duket se kishte qenë në një zonë me rëndësi strategjike dhe rrugë e sigurt për një tërheqje të sigurt për hungarezët, gjë që tregon për lidhjet historike, burimet natyrore ose faktorët politikë të kësaj lidhjeje.<sup>60</sup>

Skënderbeu që ishte rrugës për në betejën e Huniadit, ishte në këtë kohë në një distancë prej 20 mijë hapash larg fushës së betejës. Duke pasur parasysh që hapi nuk është masë shumë e saktë matëse sepse varion nga personi në person, në varësi të gjatësisë së hapit, ndryshimeve rajonale apo shpejtësisë së ecjes, si dhe nga relievi. Po të bazohemi në hapin romak që është rreth 0,75 metra, del që 20.000 hapa ishin të barabarta me 15.000 metra. Kjo do të thotë që Skënderbeu me ushtrinë e tij ishin jo më larg se 15 km, kur u ndeshën me ushtarët hungarezë që po arratiseshin nga fushëbeteja. Ky është një argument i fuqishëm që tregon se Skënderbeu ishte në Kosovë dhe madje jo më larg se dy orë rrugë nga fushëbeteja, më 19 tetor 1448, ditë kjo kur u larguan nga fushëbeteja shumica e ushtarëve hungarezë.

## Përfundime

Në këtë fragment, Bonfini shpreh tërë kreativitetin, zgjuarsinë, profesionalizmin dhe mjeshtërinë e krijuesit, duke treguar presionin psikologjik dhe vrasjen e ndërgjegjes së Huniadit pas humbjes së betejës, si dhe gjendjen e rënduar shpirtërore të tij pas disfatës së dytë me radhë nga turqit, pasojat e së cilës nuk i përballoi deri në vdekje. Ai përballlet me një dilemë të vështirë: a të vazhdojë luftën me një ushtri të dobësuar, apo të pranojë një lloj kompromisi. Fisnikët dhe ushtarët e inkurajojnë Huniadin të vazhdojë luftën, duke i premtuar besnikërinë e tyre. Huniadi është skeptik në lidhje me aftësinë e tij për të vazhduar luftën, veçanërisht pasi ka parë se shumë ushtarë po braktisin frontin në momente vendimtare të betejës, duke mos u treguar në nivelin dhe rolin që ata kishin marrë para se të niseshin për luftë. Pa mbështetjen e ushtrisë, ai nuk mund të vazhdonte të sundonte. Kjo tregon rëndësinë e marrëdhënies së besimit të ndërsjellë midis komandantit dhe ushtrisë në një shoqëri feudale mesjetare. Fragmenti thekson se ushtarët që kishin lënë fus-

<sup>60</sup> Johannes Gelcich, Ludovicus Thallóczy, *Ragusa és Magyarország összeköttetéseine. Oklevéltára. A Raguzai állami, a Bécsi cs. és kir. Titkos és egyéb levéltárakban levő okiratokból. /Diplomatarium relationum reipublicae Ragusinae cum regno Hungariae/*. (Budapest: Kiadja a M. Tud. Akadémia Tört. Bizottsága, 1887).

hëbetejën dhe ishin arratisur në Iliri, kishin gjetur siguri dhe mjete për t'u kthyer në shtëpitë e tyre. Kthimi i të ikurve nuk ishte një proces i rastësishëm. Ata u ndihmuan nga forcat ushtarake të Skënderbeut, gjë që tregon se kishte një organizim dhe një përpjekje të koordinuar për këtë luftë të hungarezëve dhe shqiptarëve. Skënderbeu që ishte rrugës për në betejën e Huniadit, ishte në këtë kohë në një distancë prej 20 mijë hapash larg fushës së betejës. Duke pasur parasysh që hapi nuk është masë shumë e saktë matëse sepse varion nga personi në person, në varësi të gjatësisë së hapit, ndryshimeve rajonale apo shpejtësisë së ecjes, si dhe nga relievi. Po të bazohemi në hapin romak që është rreth 0,75 metra, del që 20.000 hapa ishin të barabarta me 15.000 metra. Kjo do të thotë që Skënderbeu me ushtrinë e tij ishin jo më larg se 15 km, kur u ndeshën me ushtarët hungarezë që po arratiseshin nga fushëbeteja. Ky është një argument i fuqishëm që tregon se Skënderbeu ishte në Kosovë dhe madje jo më larg se dy orë rrugë nga fushëbeteja, më 19 tetor 1448, ditë kjo kur u larguan nga fushëbeteja shumica e ushtarëve hungarezë.

## Bibliografi:

### Burime të botuara:

- Bonfinius, Antonius Ascolanensis (Antonio Bonfini), *Rerum Vngaricarum Decades tres, nunc demum industria martini Brenneri Bistriciensis Transsylvani in lucem aeditae, ante hac nunquam excusae. Quibus accesserunt Chronologia Pannonum a Noah usque haec tempora, et Coronis Historiae Vngaricae diuersorum Auctorum. Basileae: Ex Roberti Vvinter Officina, anno MDXLIII (1543). Cum Caesarea Maiestatis gratia et privilegio ad annos sex.*
- Bughetti, Benevenuto. “Documenta inedita de S. Bernardino Senensi, O.F.M. (1430-1445)”, në: *Archivium Franciscanum Historicum*, XXIX. (Grottaferrata, 1936), 478-500, këtu 494, ref. 10.
- Fogel, I., B. Iványi et L. Juhász, ed. *Antonius de Bonfinis, Rerum ungaricarum decades. Bibliotheca Scriptorum Medii Recentisque Aevorum, saeculum XV*, Leipzig: B. G. Teubner, 1936.
- Gelcich, Johannes dhe Ludovicus Thallóczy, *Ragusa és Magyarország összeköttetéseine. Oklevéltára. A Raguzai állami, a Bécsi cs. és kir. Titkos és egyéb levéltárakban levő okiratokból. /Diplomatarium relationum reipublicae Ragusinae cum regno Hungariae/*. Budapest: Kiadja a M. Tud. Akadémia Tört. Bizottsága, 1887.
- Ignatius Parrino, *Acta Albaniae Vaticana, Res Albaniae saeculorum XIV. et XV, atque cruciatam spectantia*. Tomus I. Studi e Testi, 266. Citta del Vaticano: Studi e Testi, 1971.
- Schwandtneri, Ioannis Georgi. *Scriptores rerum Hungaricarum veteres, ac genuini partim primum ex Bibliotheca Augusta Vindobonensi Eruti; partim antheac quidem editi, nunc vero ex rarissimis et optimis editionibus ab innumeris mendis undicati. Amplissima praefatione Mathiae Belii*. Tomus secundus. (Bibliopolae Vindobonensi: Impensis Ioannis Pauli Kraus, 1746), vëll. II.
- Valentini S. J., Giuseppe, Matteo Sciambra, Ignazio Parrino. *Il “Liber Brevium di Calisto III la Crociata, l’Albania e Skanderbeg. Descrizione, introduzione, edizione in regesto e parzialmente integra, e indici. /Centro Internazionale di Studi Albanesi–Palermo; Istituto Universitario Orientale’Napoli; Istituto di Studi Albanesi dell’Università di’Roma; Fondazione Giorgio Cini-Venezia; Pontificum Institutum Orientalium Studiorum-Roma/*. Palermo: Scuola Grafica Salesiana, Palermo, 1968.
- Valentini, S.J., Josephi. *Acta Albania Veneta. Saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini, S.J. Labore reperta et transcripta ac typis mandata. Pars Tertia. Periodum*

Skanderbegianam complectens. Tomus *Vigesimus*. Annos a MCDXLVIII ad MCDL illustrans. Centro Internazionale Studi Albanesi "Rosolino Petrotta", Università, Palermo – Inst. Universitario Orientale, Napoli – Inst. Studi Albanesi Università, Roma – Fond. Giorgio Cini, Venezia – Pont. Ist. Studi Orientali, Roma – Albanien Inst. Universität München - Institut F. Geschichte U. Kultur D. Nachen Orients, Sowie F. Turkologie, Universität München – Südost Institut, München – Archivum Academie Scient. et Art Slavor. Merid., Zagreb – Monast. Eparch. S. M. Cryptoferr. (München: Rodulfo Trofeniko editore. – Monaci in Bavaria. Dr. Dr. Rudolf Trofenik - Verlag – Elisabethstr. 18. Impressus in Typographia Pont. Universitatis Georgianae – Roma, 1974.

### Literatura:

- Antoche, Emanuel Constantin. "Hunyadi's Campaign of 1448 and the Second Battle of Kosovo Polje (October 17-20), in *Reconfiguring the Fifteenth-Century Crusade*, edited by Norman Housley. Palgrave Macmillan, 2017: 245-284.
- Berisha, Gjon. "Gjergj Ksrioti-Skënderbeu dhe qëndrimi modus vivendi i Republikës së Raguzës", në: *Gjergj Kastrioti- Skënderbeu në 550 – vjeotrin e vdekjes*. (Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes", mbajtur në Prishtinë, më 16 tetor 2018). Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, 2019: 15-41.
- Capelli, Adriano. *Cronologia, Cronografia e Calendario Perpetuo dal principio dell'Éra Christiana ai nostri giorni. Tavole cronologico-sincrone e quadri sinottici per verificare le date storiche. Sesta edizione aggiornata*. Stampato da Legoprint S. r. L., Trento. Milano: Editore Ulricho Hopeli, 1988.
- Ducellier, Alain. "La façade martitime de la principauté de Kastriote, de la fin du XIV<sup>e</sup> siècle à la mort de Scanderbeg", në: *Studia Albanica*, VI. Tiranë, 1968: 119-136.
- Jovanović, Vojislav S. "Sredovjekovni grad Zvečan. (Fortesse médiévale de Zvečan)", në: *Starinar*. Nova Serija. Knjiga XIII-XIV /1962-1963/. Beograd: Arheološki Institut, 1965: 137-150
- Kostić, Mita. "Opis vojske Jovana Hunijadia pri polaska u boj na Kosovo", në: *Gladnik Skopskog naučnog društva. (Bulletin de la société scientifique de Skoplje)*. Knjiga (Tome) I, sveska (fasc) 1-2. Shkup, 1926: 79(1) – 91(13),
- Lajçi, Lulëzim. "Skënderbeu dhe lufta e dytë e Kosovës (17-19 tetor 1448)." *Studime historike*, I. Instituti Albanologjik i Prishtinës. (Prishtinë, 2006): 15-52.
- Matković, Petar. "Putovanja po balkanskom poluotoku XVI. veka. Napisao Dr. Petar Matković. I. *Fedlix Petančić i njegov opis puteva u Tursku*. Preštampano iz XLIX knjige Rada jugoslovenske akademije znanosti i umjetnosti. Zagreb:

- Tisak Dioničke Tiskare, 1879: 1-92.
- Pall, Francisc. "I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV. (*Documenti inediti con introduzione e note storico-critiche*)", në: *Archivio Storico per le Province Napoletane*. Publicasto a cura della Societa Napoletana di Stoira Patria. Terza serie. Anno IV, LXXXIII dell'intera collezione. (Napoli: Società Napoletana di Storia Patria 1966), ser. III, vëll. LXXXIII: 123-226.
- Pandžić, Bazilije. "I francescani a servizio dell'Albania nell'epoca di Scanderbeg", në: *V Convegno internazionale di studi Albanesi. /V Mbledhje ndërkombëtare studimesh Shqiptare. IX 1968. Atti-Aktet/*. Palermo: Scuola Grafica Salesiana-Palermo, 1969: 177-202.
- Plasari, Aurel. *Arbni historik, gjeografik, kishtar dhe politik*. Akademia e Shkencave Albanologjike. *Botimi i dytë*. Tiranë: Onufri, 2020.
- Plasari, Aurel. *Skënderbeu. Një histori politike*. Instituti i Studimeve Shqiptare "Gjergj Fishta" Tiranë. Tiranë: Instituti i Studimeve Shqiptare "Gjergj Fishta," 2010.
- Radonić, Jovan. *Đurađ Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*. Istoriska građa. Spomenik XCV. Drugi razred, knj. 74. Srpska Kraljevska Akademija. (Beograd: SKA, 1942), vëll. XCV, bleni 74: 16-17, dok. 23 dhe 17-18, dok. 24.
- Setton, Kenneth. *The papacy and the Levant, 1204-1571: The thirteenth and fourteenth centuries*. Vëll. II. Philadelphia: American Philosophical Society, 1997, 1978.

**Etleva LALA**

Vlkshochule Heibronn- Germany

Email: etlevalala@yahoo.com

ORCID: 0009-0000-5498-3151

KUD: 94(496.51)''1448''(05)

**SUMMARY****THE SECOND BATTLE OF KOSOVO (1448) ACCORDING  
TO ANTONIO BONFINI**

In this passage, Bonfini displays his full creativity, intelligence, professionalism, and literary craftsmanship, illustrating the psychological pressure and the moral torment Hunyadi faced after the defeat, as well as the deep spiritual distress he endured following his second consecutive loss to the Ottomans - consequences he never overcame until his death. He is confronted with a difficult dilemma: whether to continue the war with a weakened army, or to accept a form of compromise. The nobles and soldiers encourage Hunyadi to continue fighting, pledging their loyalty to him. Hunyadi, however, is skeptical about his ability to carry on, especially after witnessing many soldiers abandon the front at decisive moments of the battle, failing to rise to the level and responsibility they had assumed before setting out to war. Without the support of his army, he could not continue to rule. This underscores the importance of mutual trust between a commander and his army in a medieval feudal society. The fragment emphasizes that the soldiers who had abandoned the battlefield and fled to Illyria had found safety and means to return to their homes. The return of the fugitives was not a random process. They were assisted by Skanderbeg's military forces, indicating that there was organization and a coordinated effort in this campaign by the Hungarians and Albanians. Skanderbeg, who was on his way to Hunyadi's battle, was at that time at a distance of 20,000 steps from the battlefield. Considering that a "step" is not a very precise unit of measurement- since it varies from person to person depending on stride length, regional differences, walking speed, and terrain - if we base it on the Roman pace, which is about 0.75 meters, 20,000 steps equal approximately 15,000 meters. This means that Skanderbeg and his army were no more than 15 km away when they encountered the Hungarian soldiers flee-

ing from the battlefield. This provides a strong argument that Skanderbeg was in Kosovo and less than a two-hour march from the battlefield on October 19, 1448, the day most of the Hungarian soldiers left the field.